

PROBLEME INTERPRETUESE DHE ZGJIDHJE KOHERENTE NË KUADRIN E DISIPLINËS SË PËRGJEGJËSISË PENALE TË PERSONAVE JURIDIKË NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË

Disa sygjjerime mbi teknikat mbrojtëse të personave juridikë
si në planin jashtë gjyqësor, ashtu edhe në atë gjyqësor

Avv. Prof. assoc. Dr. Ersi BOZHEKU¹
Anëtar i Urdhrit të Avokatisë,
Romë (Itali)

Hyrje

Kanë kaluar rreth 14 vite nga momenti i futjes në sistemin juridik shqiptar të disiplinës së përgjegjësive penale të personave juridikë. Edhe pse aktet ndërkombëtare, veçanërisht ato të BE-së dhe të Këshillit të Evropës dispijlojnë dhe kërkojnë me ngulm uniformimin e legjislacioneve mbi këtë tematikë, ende qëndron fakti i vështirësive konkrete që ajo sjell jo vetëm në planin e implementimit të dispozitave ligjore brenda sistemeve juridike, por veçanërisht në atë të kuptimit të disiplinës, interpretimit korrekt të saj në planin doktrinor, jurisprudencial dhe të administrimit të personave juridikë në kadrin e orgnizimit koherent të tyre në respekt të saj.

Në planin formal mund të themi se, edhe Shqipëria ka një legjislacion mbi tematikën. Por lindin pyetjet: Sa koherent është ai në lidhje me parimet bazë të së drejtës penale? Sa është niveli i interpretimit të tij në planin doktrinor? Po në atë të jurisprudencës? Sa vetëdije ka nga ana e kompanive tregëtare mbi këtë disiplinë dhe sa janë ato të organizuara në këtë plan?

Problemi i aplikimit të kriterëve tradicionale të përgjegjësive penale të personave fizikë dhe personave juridikë

Nga ana formale mund të themi se edhe në Shqipëri kemi kaluar nga parimi “*societas delinqueri e puniri non potest*” ne parimi “*societas delinquere potest et puniri debet*”,² edhe pse nuk mund të mos nënvizojmë qëndrimin e një kundërshtie të përgjegjësive penale të shoqërive me parimet e përgjegjësive penale personale³ dhe përgjegjësive me faj të individit.⁴

¹ Avv. Prof. assoc. Dr. Ersi Bozheku është, gjithashtu, Profesor i së Drejtës Penale në Bordin Drejtues të Shkollës së Doktoraturës në të Drejtë Publikë në Fakultetin Juridik të Universitetit ‘Sapienza’ të Romës; ekspert në Fushën e Përgjegjësive Penale të Personave Juridike; drejtues i Organizmave të Kontrollit të Vigjilencës për parandalimin e përgjegjësive penale të personave juridikë i kompanive të licensuara dhe të njohura ndërkombëtarisht si “Mc Donalds” apo “Casino LasVegas” në Itali

² Doktrina e së drejtës penale tradicionalisht ka mohuar mundësinë e një përgjegjësie penale për personat juridik. Për më shumë se një shekull teoria e së drejtës penale i ka qëndruar besnike mësimëve të Carl Von Savigny, sipas të cilit vetëm personi fizik mund të zotërojë të drejtën, ndërsa personi juridik, duke pasur nevojë për përfaqësues për zhvillimin e aktivitetëve të tij, përbën thjesht një funksion juridik dhe, si i këfillë, nuk mund të kryejë personalisht vepra penale. Nga këtu rrejdhet dhe shprehja e famshme: “*Societas delinquere non potest*”. C.V. SAVIGNY, *Sistema del diritto romano attuale*, vol. II, Bologna, 1900. Megjithatë, nuk kanë munguar opinione të ndryshme të cilat – në mënyre krejt të kundërt me teorinë e funksionit – kanë theksuar se shoqëritë janë subjekte të së drejtës njësoj si personat fizik. Përfaqësuesit e shoqërive nuk mund të vecohen nga to, pasi janë organe me anë të të cilave shprehet vullneti shoqëror, ashtu si goja e njeriut shpreh fjalët e tij. GIERKE V, *Das deutsche Genossenschaftsrecht* Db. I, Berlin, 1868.

³ Nga ky parim rrjedh, siç është e njohur, ndalimi i përgjegjësive penale për fakte të realizuar nga individë të tjerë që do të thotë, nga ana pozitive, që gjithsecili mund të dënohet vetëm për një fakt të vetin, të parashikuar nga ligji si vepra penale. Por, për t’i aplikuar individit që vepron një fakt është e nevojshme që ky i fundit t’i përkasë atij si nga ana objektive, ashtu dhe nga ana subjektive. Objektivist një fakt mund t’i përkasë një individ në qoftëse është rrjedhojë e drejtpërdrejtë e veprimit apo të mosveprimit të individit. Pra në qoftëse ekziston një lidhje shkakësore midis sjelljes së individit dhe rezultatit të kësaj sjellje, fakti i realizuar mund të quhet i vetë individit. Nga ana subjektive një sjellje

Siç është e njohur, fajësia, në konceptin e saj modern si fajësi në aspektin normativ dhe jo subjektiv - doktrinë kjo e tejkualuar prej shumë vitesh -, ⁵ është e lidhur me konceptin e personit në gjendje të orientojës veprimet e tij me vetëdije. Për të vënë një person përpara përgjegjësisë penale duhet që fakti ⁶ i realizuar t'i përkasë personit, domethënë të realizohet jo vetem nga ana materiale, por edhe në mënyrë të ndërgjegjshme e të vullnetshme nga vetë individi. Parimi i personalitetit kërkon nga një anë realizimin e faktit material nga individi (personalitet në kuptim të ngushtë), nga ana tjetër kërkon që vepra penale t'i nënshkruhet subjektivisht personit. ⁷ Pra, duhet që vepra penale të kryhet personalisht dhe me faj. ⁸ Vetëm në këtë mënyrë dënimi mund të realizojë funksionin themelor të riedukimit të të dënuarit. ⁹

mund të quhet e një individi vetëm nëse nuk është e imponuar nga një forcë e pashmangshme e cila i heq vepruesit çdo lloj kontrolli mbi situatën reale. Për të quajtur një sjellje si personale është e nevojshme që subjekti që vepron të ketë mundësi për të kuptuar çfare bën dhe veprimi të jetë i lirë dhe i pa kushtëzuar nga jashtë. Mbi këto aspekte shih E. BOZHEKU, *Fajësia. Disa aspekte teorike, metodologjike, funksionale dhe praktike të elementit të dytë të veprës penale*, në *E drejta- Laë*, n. 2/2010, Prishtinë, f. 118, dhe vazhdim; E. BOZHEKU, *Analiza e veprës penale*, në *Jeta juridike*, n. 2, qershor, 2011, f. 78 dhe vazhdim.

Këto elemente përbëjnë minimumin për të dhënë një gjykim rreth përgjegjësisë. Një individ mund të quhet përgjegjës vetëm nëse, duke patur mundësi për të mbajtur një sjellje konform rregullave ligjore, në mënyrë të vetëdijshme, mban një sjellje të kundërt. Pra, për të qenë përgjegjës nga ana penale për një fakt është e nevojshme që vetë fakti të jetë i kontrollueshem nga vullneti i subjektit që vepron. (RAMACCI F., *Corso di diritto penale*, II ed. Torino, 2003, f. 50.). Shih edhe E. BOZHEKU, *Fajësia. Disa aspekte teorike, metodologjike, funksionale dhe praktike të elementit të dytë të veprës penale*, në *E drejta- Laë*, n. 2/2010, Prishtinë, f. 118, dhe vazhdim.

⁴ Në kodin tonë fajësia është parashikuar shprehimisht në nenin 14, në bazë të të cilit "...Askush nuk mund të dënohet për një veprim ose mosveprim të parashikuar nga ligji si vepër penale, në qoftë se vepra nuk është kryer me faj. Quhet me faj, personi që kryen veprën me dashje ose me pakujdesi...". Ashtu siç është theksuar në doktrinë, me faj kuptohet qëndrimi psikik që mban personi ndaj veprimit ose mosveprimit të paligjshëm dhe pasojave të dëmshme. Ky qëndrim psikik shprehet me qëndrimin e personit ndaj veprimit apo pasojave të tij, të cilat duhet të parashikohen/përfytyrohen dhe të dëshirohen, ose që vijnë nga pakujdesia. I. ELEZI – S. KACUPI – M. HAXHIA, *Komentari i K1odit Penal të Republikës së Shqipërisë*, Tiranë, 2006, f. 112.

⁵ Konceptimi i fajësisë në aspektin subjektiv, d.m.th. si qëndrimi psikik i mbajtur nga subjekti aktiv ndaj veprimit apo mosveprimit të paligjshëm dhe pasojave të dëmshme të tij (SH. MUÇI, *E drejta penale, pjesa e përgjithshme*, Tiranë, 2007, f. 137) është një koncept i kaluar prej shumë vitesh nga doktrina e së drejtës penale. Doktrina moderne e së drejtës penale flet për fajësi në kuptimin normativ, e kuptuar si qortim i individit që me sjelljen e tij tregon një mos pranim të rregullave të krijuara për të garantuar bashkëjetesë paqësore; këto rregulla në rradhë të parë janë dispozitat penale. G. LATTANZI, *Reati e responsabilità degli enti*, Milano, 2005, f. 10 dhe vazhdim.

⁶ Është e njohur që në teorinë e së drejtës penale fjala fakt dhe vepër penale janë sinonime. Vepra penale nuk është gjë tjetër veçse parashikimi i një fakti nga ligjvënësi në një dispozitë ligjore, realizimi i të cilit sjell si pasojë aplikimin e një sanksioni. Prandaj fjala fakt duhet kuptuar si sinonim me fjalën veper penale. Mbi këtë argument F. RAMACCI, *Corso di diritto penale*, II ed., Torino, 2003, f. 6. Shih edhe E. BOZHEKU, *Parimi i legalitetit dhe nënparimet e tij*, në *Jeta Juridike*, n. 2, dhjetor, 2009, f. 91 dhe vazhdim.

⁷ Nuk mund të flitet për përgjegjësi penale në rastin e X i cili në një shpërthim epileptik vret Y. Në këtë rast X nuk mund të përgjigjet për vrasje pasi vepra penale i përket vetëm nga ana materiale. Nga ana e elementit subjektiv mungon ndërgjegjja dhe vullneti i veprimit (e quajtur SUIITAS) përpara mungesës së përfytyrimit dhe dashjes së faktit të kryer. F. ANTOLISEI, *Manuale di diritto penale*, p.g., a cura di Luigi Conti, Milano 2000, f. 342.

⁸ Këto parime janë të përbashkëta për të gjitha legjislacionet penale moderne. Në Shqipëri edhe pse në Kushtetutë nuk hasim asnjë nen që shprehimisht përcakton përgjegjësinë penale personale e fajtores, këto parime, në mënyrë interpretative, mund t'i nxjerrim nga nenet 1/c, 2 dhe 4 të kodit penal si dhe nga neni 28 paragrafi 5 i Kushtetutes. Neni 1/c parashikon: "...Kodi penal bazohet në parimet kushtetuese të shtetit të së drejtës, të barazisë para ligjit, të drejtësisë në caktimin e fajësisë dhe dënimit, si dhe të humanizimit...". Neni 2 k.p. par. 1 parashikon: "...Askush nuk mund të dënohet penalisht për një vepër penale që më parë nuk është parashikuar shprehimisht në ligj si krim ose si kundravajtje penale...". Neni 4 k.p. parashikon se "...mosnjohja e ligjit që dënon veprën penale, nuk përbën shkak për përjashtimin nga përgjegjësia penale, vec rasteve kur është objektivisht e paevitueshme...".

Nga këto nene del në pah se për tu aplikuar një vepër penale individi duhet të njoh, ose të ketë mundësinë të njohë, që fakti që ka kryer është në kundërshtim me objektin juridik të mbrojtur nga ligji. Në fakt, vetëm njohja paraprake e ligjit bën të mundur që individi të orientojë në mënyrë të vetëdijshme veprimet e tij (neni 4). Në të kundërt aplikimi i normativës për fakte të kryera në një moment para nga hyrjes në fuqi të dispozitës penale do të ishte absurd. Individi do të dënohej për një fakt të kristalizuar historikisht rreth të cilit nuk mund të ketë më mundësinë të orientojë veprimtarinë e tij. Në këto kushte fajësimi do të ishte i pa drejtë, duke dhunuar kështu nenin 1/c k.p.

Është e qartë që kur flitet për njohjen e ligjit nga ana e individit nuk pretendohet një njohje efektive. Do të ishte absurde të lihej nën bindjen personale të gjithkujt njohja apo mosnjohja e ligjit penal. Ajo që është e nevojshme është mundësia

Në qoftë se pranojmë që personi juridik përbën një entitet të veçantë nga personat fizikë që e përbëjnë: domethënë, në qoftë se personi juridik konsiderohet si subjekt juridik autonom (i veçantë), në gjendje për të qënë qendër të drejtash dhe detyrimesh, atëherë lind problemi se si një subjekt i ketillë mund të përgjigjet për vepra penale të realizuara nga personat fizikë në gjirin e tij.

Një problem i parë lind me faktin se personi juridik në qoftë se vihet në përgjegjësi për fakte¹⁰ (vepra penale) të realizuara nga individë të tjerë (për shembull administratorët apo përfaqësuesit), thirret të përgjigjet për vepra penale të realizuara jo personalisht por nga subjekte krejt ndryshe nga ai. Në këtë menyrë fajësimi i personit juridik bëhet për faktin e vetëm se vepra penale realizohet nga një individ në gjirin e tij, pa pasur asnjë mundësi për të evituar realizimin e këtij fakti. Me fjalë të tjera, përgjegjësia e personit juridik shfaqet si përgjegjësi thjesht objektive (*versari in re illicita*).¹¹ bazuar në faktin e vetëm se një veper penale është realizuar nga një nga organet e tij, në mungesë të çdo lloj lidhjeje psikike midis personit juridik dhe veprës penale.

e njohjes së ligjit nga pjesëtarët e shoqërisë e cila garantohet me anë të publikimit të ligjit në fletoren zyrtare. Nga ky moment kushdo ka mundësinë të njohë çfarë detyrash e çfarë të drejtash rrjedhin nga ligjet në fuqi. Në qoftëse injorohen këto detyra, siç tregon realizimi i veprave penale, atëherë individi tregon se është i pandjeshëm rreth detyrimeve që ka drejt shoqërisë: ky fakt justifikon dhe bën të nevojshëm dënimin e këtyre subjekteve.

Për të thelluar këto parime shih I. ELEZI – S. KACUPI – M. HAXHIA, *Komentari i Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë*, Tiranë, 2006

⁹ Citimi i humanizimit si parim bazë i Kodit Penal bën që ky nen të marrë një funksion themelor për interpretimin e të gjitha dispozitave penale. Parimi i humanizimit ka të bëjë dënimin e individit, madje funksioni i dënimit është humanizimi i individit, domethënë riedukimi i tij rreth vlerave sociale të cilat nuk njuh ose nuk respekton. Në qoftë se i pandehuri do të njihet apo do të respektohet këto vlera nuk do të kishte kryer veprën penale. Nuk mund të flitet për humanizim/riedukim të individit në qoftë se nuk ka pasur mundësinë për të njohur kush janë faktet të cilat konsiderohen nga ligjvënësi në kundërshtim me vlerat shoqërore. Ja pra lidhja e pa ndashme midis principit të fajësisë dhe principit të humanizim/riedukimit. Nuk mund të riedukohet një subjekt i cili nuk është me faj sepse objektivisht nuk ka pasur mundësi për të njohur dispozitën penale. Për shembull: ndodh një katastrofë natyrore dhe ndërpriten komunikimet me disa zona të vendit, në këtë periudhë ligjvënësi nxjerr dispozita penale të reja. Është e qartë se banorët e zonave të goditura nga katastrofa nuk mund të përgjigjen për veprat penale të dala në këtë periudhë sepse objektivisht nuk kanë patur mundësinë për të njohur dispozitat e për të orientuar në mënyrë të ndërgjegjshme e të vullnetshme veprimet e tyre. Në keto situata do të ishte absurde pasi nuk mund të ketë asnjë lloj vlere riedukuese.

Humanizimi dhe fajësia si parime themelore të legjislacionit tonë gjejnë konfirm të plotë në nenin 28 paragrafi 5 të Kushtetutës së Shqipërisë i cili thotë “...Çdo person, të cilit i është hequr liria sipas nenit 27, ka të drejtën e trajtimit njerëzor dhe të respektimit të dinjitetit...”. Në bazë të argumentimeve të zhvilluara më sipër nga kjo dispozite mund të nxjerrim në formë minimale ndalimin e torturës dhe trajtimeve çnjerëzore, në mënyrë të gjerë, në harmoni me parimet e kodit penal e veçanërisht konform Kartes të të Drejtave të Njeriut, që dënimin penal duhet të vështrojë rreth rikuperimit social të individëve që kanë kryer vepra penale. Ky rikuperim fillon në rradhë të parë duke respektuar dinjitetin e të dënuarit dhe së dyti, të paktën në princip, duke finalizuar institutin e burgimit në institut të rikuperimit social. Siç mund të shihet, parimet e së drejtës penale janë thelbësore për të orientuar profesionistët e së drejtës (studentët, avokatët, gjykatësit) në zhvillimin e aktivitetit të tyre profesional konform ligjit. Prandaj, ky i fundit nuk mund të jetë thjesht objekt leximi, por duhet t'i nenshtrohet një interpretimi rigoroz. Nga interpretimi sistematik i dispozitave të cituara më sipër del në pah se edhe në kodin tonë principet e fajësimit, humanizimit, njohjes së ligjit penal etj, përbëjnë themelin e të gjithë legjislacionit penal.

¹⁰ Mbi përdorimin e fjalës “fakt” dhe jo “veper penale” jemi të mendimit se shprehja e parë është më e përshtatme pasi identifikon një realitet konkret, ndërsa fjala vepër penale është thjesht një terminologji abstrakte që nuk i përshtatet parimit të precizionit dhe që gjithsesi nuk nënkupton gjë tjetër veç faktin. Për këtë arsye jemi të mendimit se duke përdorur fjalën fakt jemi më në përputhje me parimet e precizionit, të taksativitetit dhe të tipicitetit. Me anë të përdorimit të kësaj shprehjeje evitohen kritikata e shumta që doktrina botërore i kushton të drejtës penale shqiptare në përgjithësi, dhe kodit tonë penal në veçanti. Për këto kritika tepër të ashpra shih: P. PITTARO, *Il codice penale albanese: un'introduzione*, Riv. Diritto penale XXI secolo, n. 2, Bologna, 2006, f. 197. A. MANNA, *L'imputabilità nel codice penale albanese del 1995*, Riv. Diritto penale XXI secolo, n. 2, Bologna, 2006, f. 221 dhe vazhdim. M. BERTOLI, *Su alcuni problemi nella traduzione del codice penale albanese: tra fedeltà del testo ed efficacia linguistica*. Riv. Diritto penale XXI secolo, n. 2, Bologna, 2006, f. 263. E. BOZHEKU, *Parimi i legalitetit dhe nënparimet e tij*, në Jeta Juridike, n. 2, dhjetor, 2009, f. 91 dhe vazhdim; E. BOZHEKU, *Some remarks about the albanian criminal code in Conference Proceedings*, Vol. III, *Challenges of Albania's Integration in European Union*, Tiranë, 2010, p. 195 ss; E. BOZHEKU, *Alcune riflessioni sul codice penale albanese*, në *Diritto&Diritti, Rivista giuridica elettronica pubblicata su Internet*, URL : <http://ëëë.diritto.it>, ISSN : 1127-8579, korrik, 2010, ëëë.diritto.it/docs/30027;

¹¹ Përgjegjësia penale objektive është një koncept mesjetar i bazuar në thënieën “...*versari in re illicita etiam pro casu tenetur*...”. Kushdo që kryen një paligjshmëri përgjigjet për të gjitha pasojat që vijnë nga ky veprim. Ky parim i cili ka

Mund të thuhet, për të kaluar këtë vërejtje, se personi fizik që kryen veprën penale e bën në emër dhe në dobi të personit juridik i cili nga ana materiale ka avantazhe apo rezultate pozitive nga realizimi i faktit të jashtëligjshëm. Megjithatë problemi në lidhje me parimin e fajësisë vazhdon të qëndrojë. Për të respektuar këtë parim është e nevojshme që personi juridik të jetë në dijeni rreth veprimtarisë së paligjshme të organeve të tij dhe të jetë gjithashtu në gjëndje për të shmangur realizimin e veprës penale nga ana e personit fizik: është e nevojshme një lidhje subjektive midis personit juridik dhe veprës penale. Vetëm në këtë mënyrë personi juridik mund të jetë përgjegjës për faktet që realizojnë organet e tij. Me fjalë të tjera, vepra penale duhet të jetë dashur ose gjithsesi personi juridik duhet të jetë në dijeni dhe me neglizhence e lejon realizimin e saj.¹²

Por (dhe këtu vërejtja më e fortë) si mund të flitet për lidhje subjektive për një entitet që ekziston vetëm nga ana juridike por nuk është njeri? Administratorët dhe përfaqësuesit e shoqërive mund të ndryshohen nëse kryejnë vepra penale, por personi juridik si mund të përgjigjet për veprimtaritë e zyrtarëve të këtyre subjekteve?¹³

Bazat ideologjiko-parimore-konceptuale të përgjegjësisë penale të personave juridikë

Për të kuptuar themelet e përgjegjësisë penale të personave juridikë, duket në rradhë të parë të shkëputemi nga parimet mbi të cilat mbështeten institutet e së drejtës penale klasike të personave fizik.

Duhet të kuptojnë, në rradhë të parë, që përgjegjësia penale e personave juridik është një përgjegjësi penale paralele – ku për arsye të lidhura me specifikën e subjektit (personit juridik) të cilit i aplikohet kjo disiplinë – e cila është totalisht e ndryshme nga ajo e personave fizikë. Si rrjedhim dhe rregullat e përgjegjësisë të parashikuara për personin juridik janë thelbësisht të ndryshme nga ato të parashikuara për personat fizikë.

Koncepte si sjellja (veprimi apo mos veprimi) dashja dhe pakujdesia, janë tipike të përgjegjësisë penale të personave fizikë, por nuk mund t'i aplikohen në asnjë mënyrë personit juridik.

mbretëruar për shekuj në legjislacionet botërore sot është i tejkaluar. Bëhet fjalë për një parim që bazohet vetëm në lidhjen shkakësore veprim-veper penale. I qartë, pra, konflikti i përgjegjësisë objektive me principin e fajësisë, i cili kërkon që çdo element i parashikuar nga vepra penale duhet të jetë i përfytyruar (nën aspektin intelektual) dhe të jetë dashur (nën aspektin e vullnetit). Ashtu siç u theksua më parë, e drejta penale moderne bazohet jo vetëm në lidhjen shkakësore, por edhe në lidhjen psikike midis veprës penale dhe subjektit.

¹² Për sa i përket këtij aspekti, duhet patur kujdes për të mos u ngatërruar me përgjegjësinë penale me pakujdesi të personave fizikë. Në rastin për të cilin po flasim, përgjegjësia përcaktohet në bazë të kriterëve të ndryshëm nga ato të parashikuar nga kodi penal. Këto kritere janë realizimi i faktit në emër dhe në dobi të personit juridik i cili është në dijeni ose mund të ishte në dijeni të realizimit të këtyre fakteve. Përfundimi që ne japim është një përfundim “de jure condendo”, d.m.th. një përfundim subjektiv se si duhet të interpretohet – duke patur parasysh formimin tonë doktrinar – ligji nga gjykatat për të qenë konform parimeve të së drejtës penale.

¹³ Për këto arsye në sistemin italian ligji n. 231, datë 08.06.2001 nuk flet për përgjegjësi penale të personit juridik, por për përgjegjësi administrative të personave juridikë në lidhje me vepra penale ëe realizuara në interes ose në avantazh të tyre. Bëhet fjalë për një sistem para-penal të bazuar në sanksione jo penale (edhe pse procesi që zhvillohet është tipik penal në të cilin aplikohen nenet e kodit të procedurës penale italiane) mbi personat juridik për veprat penale të realizuara nga përfaqësuesit apo administruesit. Në këtë mënyrë ligjvënësi italian ka evituar që ligji në fjalë të bjerë preh e dyshimeve rreth dhunimit të parimit të fajësisë e të përgjegjësisë penale personale të parashikuar shprehimisht në nenin 27 paragrafi 1 i Kushtetutës italiane. Neni 27 paragrafi 1 i Kushtetutës italiane thotë: “...Përgjegjësia penale është personale...”. Nga ky parim, me një vendim të konsideruar “epokal”, gjykata kushtetuese italiane (vendimin n. 364/1988) ka deklaruar jo në përputhje me Kushtetutën ato norma të kodit penal të cilat nuk respektojnë parimin e përgjegjësisë personale të fajshme. Gjykata ka theksuar se një vepër penale mund të konsiderohet e realizuar nga një individ vetëm në qoftë se i përket këtij të fundit si nga ana materiale (d.m.th. e lidhjes shkakësore) ashtu dhe nga ana psikike. Në këtë perspektivë, nuk mjafton vetëm realizimi i faktit por duhet edhe një lidhje psikologjike midis autorit dhe faktit; lidhje psikologjike që duhet të kalojë të paktën në formën e fajit për pakujdesi. Ky i fundit duhet kuptuar si përgjegjësi e individit për realizimin e një fakti për të cilin po të kishte qenë më i kujdesshem do ta kishte parashikuar dhe si rrjedhojë do ta kishte, me siguri, evituar.

Përgjegjësia e këtij të fundit, në planin penal, mund të indentifikohet vetëm me elementë si mungesa e organizimit të denjë të tij për të evituar realizimin e veprave penale që shkojnë në interes të tij dhe i sjellin një dobi.

Nga ana ideologjiko-konceptuale, në qoftë se pranojmë që personi juridik është një entitet autonom interesash dhe raportesh juridike, i cili përgjigjet për aktet e ligjshme të subjekteve që e përbejnë, atëherë e njëjta logjikë duhet të vlejë edhe për faktet e paligjshme dhe pasojat e tyre. Në këtë linjë mendimesh është vërejtur se: “në qoftë se personi juridik mund të nënshkruajë kontrata, subjekti i detyrimeve që lindin nga këto kontrata është vetë personi juridik dhe është gjithmonë ky i fundit i cili mund të respektojë apo të shkelë ato. Kjo do të thotë që personi juridik mund të veprojë edhe në mënyrë të paligjshme”.¹⁴

Po të vështrojmë më në thellësi: për deri sa personit juridik ligjvënësi i njeh zotësinë për të vepruar, të pretendojë të drejta e të marrë detyrime me anë të subjekteve fizikë që e përfaqësojnë, atëherë është e arsyeshme të mendosh se personi juridik mund të quhet përgjegjës edhe për veprimet jo të ligjshme që zhvillohen në sferën e aktiviteteve të tij. Në këtë kuadër, përgjegjësia si koncept juridik mund t’i shqiptohet çdolloj subjekti që gëzon zotësinë për të vepruar.¹⁵

Së dyti, parimi i fajësisë mund të shkëputet nga konceptimi tradicional psikologjik¹⁶ për të kaluar në një konceptim (të quajtur) normativ të fajësisë. Ky i fundit bazohet në qortimin e kujdo subjekti në qoftë se nuk i pershtatet vlerave sociale të pranuar nga shoqëria. Në këtë perspektivë fajësia nuk është më lidhje psikike (personale) individ-vepër penale, por një qortim që i bëhet gjithkujt, edhe personave juridik, sepse të pa kujdesshëm në respektimin e ligjit. Në këtë kuadër është e qartë se fajësia nuk bazohet më në lidhjen subjektive fakt-dashje o fakt-pakujdesi, por në një element tjetër – qortimi – i cili mund t’i aplikohet cilitdo subjekti. Në këtë pikpamje të re, personat juridikë mund të thirren për tu përgjigjur për ato aktivitete shoqërore të cilat duke qënë vepra penale japin mundësinë për ta qortuar (personin juridik) sepse, duke pasur një organizim të dobët, nuk ka mundur të evitojë realizimin e tyre.

Përgjegjësia penale e personave juridikë në Republikës e Shqipërisë

Sensibiliteti i treguar në qarqet ndërkombetare ka shpejtuar ndërgjegjësimin edhe të ligjvënësit tonë rreth një ndërhyrje konkrete mbi disiplinimin e përgjegjësive së personave juridikë.

Formalisht përgjegjësia penale e personave juridikë afirmohet për herë të parë në kodin penal të 1995 (Ligji 7895, datë 27.01.1995) në nenin 45 K.P., i shfuqizuar në vitin 2001 dhe i ristuar në vitin 2004.¹⁷

Neni në fjalë cakton kriteret bazë të përgjegjësive penale të personave juridikë. Në paragrafin 1 përcaktohet, se: “*personat juridikë, me përjashtim të institucioneve shtetërore, përgjigjen penalisht për vepra penale, të kryera në emër ose në dobi të tyre nga organet dhe përfaqësuesit e tyre*”.¹⁸

Në mënyrë koherente me konventat ndërkombetare përcaktohet se përgjegjësia penale e personave juridikë është një përgjegjësi e pavarur (autonome) dhe paralele me atë të personit fizik,

¹⁴ K. TIEDMAN, *La responsabilità penale delle persone giuridiche*, in Riv. it. Dir. Proc. pen. 1993, f. 1246.

¹⁵ Rreth koncepteve të zotësisë juridike dhe zotësisë për të vepruar të personave fizik dhe juridik shih KONDILI, *E drejta civile I, pjesa e përgjithshme*, Tirane, 2007, f. 110, f. 139.

¹⁶ Sic është e njohur, konceptimi psikologjik i fajësisë kërkon një lidhje të ngushtë midis autorit dhe faktit-vepër penale. Fakti mund të quhet i autorit vetëm në qoftë se ky i fundit e ka parashikuar dhe dashur faktin ose mund ta parashikonte por me mendjelehtësi nuk e ka parashikuar. G. FIANDACA – E. MUSCO, *Diritto penale, parte generale*, IV ed. Bologna, 2004, f. 169

¹⁷ Neni 45 K.P. shfuqizohet më datë 24.01.2001, nga neni 4 i ligjit 8733 dhe rifutet nga neni 7 i ligjit 9275, datë 16.09.2004

¹⁸ Edhe pse formalisht përjashtohet përgjegjësia e institucioneve shtetërore, përcaktohet se ky përjashtim nuk vlen në lidhje me organet e qeverisjes vendore në lidhje me veprat penale të realizuara nga subjekte private apo publike të deleguara në administrimin e shërbimeve apo aktiviteteve publike. Shprehimisht paragrafi 2 pohon: “*Njësitë e qeverisjes vendore përgjigjen penalisht vetëm për veprime të kryera gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tyre, të cilat mund të ushtrohen nëpërmjet delegimit të shërbimeve publike.*”

në kuptimin se edhe ky i fundit është përgjegjës për veprën penale të realizuar ashtu si edhe personi juridik. Paragrafi 3 thekson se “përgjegjësia penale e personave juridikë nuk përjashton atë të personave fizikë, të cilët kanë kryer ose janë bashkëpunorë në kryerjen e të njëjtave vepra penale”.

Duhet theksuar se vlera e nenit 45 K.P. në fillimet e tij ishte thjesht simbolike, pasi konkretisht bëhej fjalë për një dispozitë programatike – apo siç quhet në mënyre korrekte nga doktrina dispozitë referuese¹⁹ – pa mundësi aplikimi konkret, aspekt ky i afrimuar shprehimisht nga vetë ligjvënësi, i cili në paragrafin e fundit të nenit 45 K.P. thekson se “veprat penale dhe masat ndëshkuese përkatëse, që zbatohen ndaj personave juridikë, si dhe procedura për vendosjen dhe ekzekutimin e tyre rregullohen me ligj të veçantë”.²⁰

Në zbatim si të nenit 45 të kodit penal, si edhe të angazhimeve të marra nga Shqipëria me ratifikimin e Konventave ndërkombëtare dhe veçanërisht me ratifikimin e “Konventës penale mbi korrupsionin” me anë të ligjit 8778, datë 26.04.2001, kanë berë që ligjvënësi ynë me datë 14.06.2007 të aprovojë ligjin 9754 mbi përgjegjësinë penale të personave juridikë për vepra penale të kryera në emër dhe në dobi të tyre.²¹

Në këtë shkrim nuk do të përqëndrohemi tek analizimi i thellë i disiplinës, pasi mendojmë se kemi arritur të shterojmë aspektet interpretuese bazë, në shkrime të tjera.²² Ajo që na intereson në këtë punim është fakti i njohjes së specialistëve të fushës me elementet bazë të interpretimit të disiplinës të cilat janë thelbësorë për hartimi e teknika mbrojtëse, shumë nga të cilat i kemi aplikuar me sukses në praktinën tonë gjyqësore dhe jashtë gjyqësore në Republikën e Italisë.²³

Natyrisht, përpara se të përqëndrohemi në këto detaje, është e rëndësishme të ri-shpjegojmë disa elementë kyç të ligjit n. 9754, datë 14.06.2007.²⁴

Ana objektive e përgjegjësise penale të personave juridikë

Neni 3 i ligjit 9754 vendos kriterin e përgjegjësise penale për personat juridik. Shprehimisht dispozita në fjalë parashikon:

“...Personi juridik ka përgjegjësi për vepra penale të kryera:

- a) në emër ose në dobi të tij, nga organet dhe përfaqësuesit e tij;
- b) në emër ose në dobi të tij, nga një person, që është nën autoritetin e personit që

¹⁹ I. ELEZI – S. KAÇUPI – M. HAXHIA, *Komentari i Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë*, cit., f. 228

²⁰ Pra, edhe pse në Shqipëri, nga ana formale, ekzistonte në kodin penal një dispozitë mbi përgjegjësinë penale të personave juridikë, konkretisht kjo e fundit – për vullnet të shprehur të ligjvënësit – ishte letër e vdekur, pasi mundësia e aplikimit të saj rezervohej dhe shtyhej në krijimin e një ligji *ad hoc*. Kjo zgjedhje e ligjvënësit është për tu vlerësuar, pasi tregon ndërgjegjësimin e këtij të fundit mbi rëndësinë e krijimit të një sistemi të veçantë përgjegjësie penale të personave juridikë, i aftë, nga një anë, për t’iu përgjigjur nevojave shoqërore për të luftuar fenomenin e kriminalitetit të shoqërive tregëtare, nga ana tjetër, i formuluar në respekt të parimeve dhe garancive themelore të parashikuara nga legjislacioni penal. Në të kundërt, një aplikim direkt i nenit 45 k.p. në vitin 1995 (apo 2004) do të kishte sjellë pasoja tepër të rënda në sistemin penal, pasi do të detyronte doktrinën dhe jurisprudencën të rishikonin – në një arsyetim analogjik (në *malam partem*) – të gjitha parimet e kodit penal duke i adaptuar ato në kuadrin e një aplikimi të përgjegjësise penale tradicionale edhe kundrejt personave juridikë. Në qoftë se kështu do të kishte ndodhur, dhunimet e kodit penal do të kishin qënë të pashmangshme: veçanërisht parimi i ligjshmërisë, parimi i përgjegjësise personale dhe parimi i fajësisë do të kishin qënë viktimat e këtij interpretimi; përfundimisht do të kishte qënë një zgjidhje totalisht e gabuar

²¹ Mbi përpueshmërinë kushtetuese të ligjit në fjalë shif Vendim i Gjykatës Kushtetuese n. 38 datë 25.07.2013 si dhe E. BOZHEKU, *Përputhshmëria kushtetuese e ligjit 9754m datë 14.06.2007 për përgjegjësinë penale të personave juridikë*, në ‘Jeta Juridike’, n. 2, 2014, f. 7 dhe vazhdim

²² E. BOZHEKU – I ELEZI, *Përgjegjësia penale e personave juridikë*, Tiranë 2017, edicion i II i rishikuar dhe azhornuar

²³ E. BOZHEKU, *La responsabilità da reato degli enti in Italia e Albania. Il ponte tra le due sponde dell’Adriatico*, Torino, 2016. E. BOZHEKU – I. ELEZI, *Përgjegjësia penale e personave juridike – Manual teorik praktik për studentë, avokatë, prokurorë, gjyqtarë, drejtues të shoqërive tregëtare, studiues dhe dashamirës të së drejtës penale*, Tiranë, 2012, f. 65. E. BOZHEKU – I ELEZI, *Përgjegjësia penale e personave juridikë*, cit. f. 56 dhe vazhdim.

²⁴ Mbi këtë aspekte shih E. BOZHEKU – I. ELEZI, *Përgjegjësia penale e personave juridike – Manual teorik praktik*, cit., f. 68

përfaqëson, drejton dhe administron personin juridik;

c) në emër ose në dobi të tij, për shkak të mungesës së kontrollit apo të mbikqyrjes nga personi që drejton, përfaqëson dhe administron personin juridik...”.

Nga dispozita në fjalë del qartë se një person juridik përgjigjet penalisht nëse veprat penale të realizuara nga personat fizikë të percaktuar në të²⁵ kryhen në emër ose në dobi të personit juridik.

Nuk mjafton, pra, realizimi i nje vepre penale nga ana e personave fizikë të parashikuar në ligj, por nevojitet, gjithashtu, që të kenë vepruar duke përfaqësuar personin juridik ose duke i sjellë këtij të fundit një avantazh.

Për sa i përket kryerjes së veprës penale “...në emer...” të personit juridik problemet interpretative janë tepër të mëdha. Nga dispozita në fjalë duket se me shprehjen “...në emer...” duhen kuptuar ato vepra penale që realizohen nga personat fizikë brenda personit juridik, kur veprojnë si organe përfaqësues të tij. Si rrjedhojë, personi juridik duhet të përgjigjet jo për çdo lloj vepre penale të realizuar nga subjektet e parashikuara në nenet 3 dhe 4, por vetëm për ato vepra që janë realizuar duke shfaqur vullnetin e tij. Edhe pse e parashikuar në ligj, nuk mund të aplikohet normativa në ato raste kur veprat penale kryhen nga subjekte që nuk mund të përfaqësojnë vullnetin e personit juridik. Në qoftë se vartësit dhe nëpunësit kryejnë akte juridike (të cilat përbëjnë vepra penale), të cilat nuk mund të kryhen nga ana e tyre, personi juridik nuk mund të përgjigjet.²⁶

Për shembull duhet të përgjigjet vetëm personi fizik dhe jo ai juridik për veprën penale të mashtrimit të bërë nga nëpunësi i shoqërisë i cili hiqet sikur vepron në emër të saj. Në këtë rast, madje, shoqëria duhet të konsiderohet person i lënduar sepse i është keqpërdorur emri.

I njëjti arsyetim duhet bërë për ato vepra penale të realizuara nga organet e personit juridik për veprime të cilat, edhe pse në emër të këtij të fundit, janë zhvilluar jashtë kompetencave të tyre: për shembull nuk mund të përgjigjet personi juridik për mashtrimin e kryer në një kontratë e cila parashikon një shumë tepër të lartë nga ana e një drejtuesi i cili nuk ka të drejtë të firmosë kontrata për shuma që kalojnë një vlerë të caktuar. Edhe në këtë rast shoqëria është palë e lënduar nga veprimtaria e paligjshme e organit të saj.

Për sa i përket elementit tjetër, d.m.th. kryerjes së një vepre penale “...në dobi...” të personit juridik, duhet kuptuar si çdo lloj avantazhi i përfituar nga personi juridik nga kryerja e një vepre penale nga personat fizikë të parashikuar në nenet 3 dhe 4. Pra nga interpretimi i dispozitës nxjerrim se me “...dobi...” duhet kuptuar përfitimi që realizohet nga shoqëria nga kryerja e veprës penale. Ky mund të jetë një përfitim monetar direkt ose mund të jetë edhe ndonjë avantazh tjetër.²⁷

Lind pyetja nëse veprat penale të realizuara nga personi fizik duhet të karakterizohen njëkohësisht nga të dy elementët “...në emer...”, “...në dobi...”?

Duket se këto elementë mund të ekzistojnë veç e veç dhe jo së bashku, sepse ligjvënësi ka përdorur lidhëzën “...ose...”, por jo lidhëzën “...dhe...”.²⁸

Në shkrime të tjera, kemi theksuar se, për mendimin tonë, kjo zgjidhje nuk mund të pranohet pasi pasojat do të ishin absurde. Në rastet e lartpërmendura personi juridik do të përgjigjej vetëm për faktin që ka pasur një avantazh nga një veprim i cili vetëm në menyrë sipërfaqësore është bazuar në emrin e shoqërisë, ose akoma më tej personi juridik duhet të përgjigjet vetëm për faktin që ka pasur një avantazh për një vepër penale të realizuar nga organet e tij edhe pse jo në emër të tij.

²⁵ Në bazë të neneve 3 dhe 4 personat fizikë, veprat penale të të cilëve mund të sjellin përgjegjësinë e personit juridik janë:

personat që përfaqësojnë, drejtojnë, administrojnë ose kontrollojnë veprimtarinë e personit juridik dhe të strukturave të tij (neni 4), si dhe nëpunësit dhe vartësit e tyre (neni 3 shkronja c.).

²⁶ E. BOZHEKU, *Përgjegjësia penale e personave juridikë. Probleme interpretuese dhe aspekte krahasuese me legjislacionin italian*, në *Jus&Justicia*, nr. 4, 2010, cit. f. 202

²⁷ Avantazh i ndryshëm nga ai ekonomik direkt mund të përfitohet në rastin e rryshfetit të dhënë një gjyqtari nga drejtuesi i shoqërisë për të evituar dënimin e njërit prej aksionerëve kryesorë në një procedim penal.

²⁸ Nuk kemi të bëjmë me një lojë fjalësh: interpretimi në një mënyrë apo në një tjetër shndërron krejtësisht të gjithë disiplinën

Po të ishte kështu²⁹ personi juridik duhet të përgjigjet edhe në rast përdhunimesh apo veprash penale që nuk kanë asnjë lidhje me objektin social të tij, por që objektivisht nxjerr një avantazh,³⁰ siç mund të jetë eliminimi fizik i administratorit të një kompanie kundërshtare duke i mohur kësaj të fundit të marrë pjesë në një ankand apo tender.³¹

Prandaj, për një interpretim korrekt, në përputhje me parimet bazë që janë në themel të legjislacionit, duhet theksuar se vepra penale e kryer nga personi fizik nuk duhet të jetë vetëm në dobi por edhe të kryhet në emer të personit juridik. Në rast se njëri nga keto elementë mungon, përgjegjësia penale e personit juridik duhet përjashtuar.

Kështu, në rastin e përdhunimit të zonjes A (administratore e shoqërisë X) në qoftëse C dhe D (administratorë të shoqërisë Y) kanë vepruar për një sodisfaksion seksual, shoqëria Y nuk mund të përgjigjet thejsh për avantazhin që ka marrë nga mos marrja pjesë në tender nga shoqëria X si pasojë e ngjarjes. Edhe në qoftë se eliminimi fizik, me anë të përdhunimit, të kundërshtares, zonjes A, është realizuar gjatë një darke/pune ku palët përfaqësonin secila shoqërinë përkatëse, prap nuk mund të flasim për përgjegjësi të personit juridik pasi vepra është realizuar duke shfrytëzuar emrin e shoqërisë; gjithësesi akti i realizuar nga C dhe D kapërcen kufijtë e kompetencave që këto subjekte kanë brenda shoqërisë Y.

Përfundimisht, shprehja “...në emer...” duhet interpretuar në mënyrë të bashkangjitur me shprehjen “...në dobi...”. Kjo zgjidhje është jo vetëm e arsyeshme nga ana sistematike, por ka edhe meritën t’i japë qëndrueshmëri interpretative të gjithë sistemit. Në rast të kundert, neni 3 duhet të deklarohet kundra ligjit në bazë të nenit 2 ligji 9754 datë 24.06.2007,³² sepse nuk është në përputhje me nenin 2 të kodit penal.³³ Pra, për të ruajtur koherencën interpretuese dhe në respekt të nenit 2 të ligjit 9754 zgjidhja e sapopërmenduar është e vetmja koherente dhe e arsyeshme.³⁴

Përgjegjësia penale e personit juridik nga ana subjektive

Problemi kryesor që lind me disiplinën e përgjegjësisë penale të personave juridikë në sistemin shqiptar është ai i elementit subjektiv.

Jemi të mendimit se zgjidhja më e përshtatshme e këtij problemi mund të jetë ndërhyrja e ligjvënësit për të bërë konkretisht funksionale dispozitat e ligjit 9754 datë 14.06.2007.

Ligji në fjalë nuk parashikon asgjë rreth kriterëve që duhen adoptuar për të treguar fajësinë ose pafajësinë e personit juridik, në plain subjektiv. Si rrjedhojë, aktualisht, disiplina e përgjegjësisë penale të personave juridikë bazohet vetëm në elementin objektiv të realizimit të veprës penale i identifikuar në termat “...në emer...” dhe “...në dobi...”.

²⁹ Bëhet fjalë për shembullin e Zonjës A, administratore e shoqërisë X, që pasi ka ngrënë darkë dhe pirë alkool me personat nga C dhe D drejtues të shoqërisë Y, konkurren të parën në një sektor industrial, bëhet objek i një përdhunimi nga dy individët e lartpërmendur. Të nesërmen shoqëria Y nuk merr pjesë në një tender për shkak të kësaj ngjarje. Shoqëria Y ka objektivisht një dobi.

³⁰ E. BOZHEKU, *Përgjegjësia penale e personave juridikë. Probleme interpretuese dhe aspekte krahasuese me legjislacionin italian*, në *Jus&Justicia*, nr. 4, 2010, cit., f. 200.

³¹ Në këtë rast do të arrihej në një përfundim të kundërt në qoftë se ligjvënësi ynë në vend të fjalës “...në emer...” të kishte përdorur shprehjen “...në interes...”. Po të ishte kështu akti i përdhunimit i kryer në interes të personit juridik mund të ishte i përfytyrueshëm. Do të bëhej fjalë për një ko incidencë interesash reciproke. Duke përdorur shprehjen “...në emer...” ky përfundim është i papranueshem, pasi kjo shprehje duhet interpretuar si ato akte të cilat kryhen duke shpenzuar emrin e personit juridik, brenda kompetencave të caktuara nga ligji i së drejtës tregtare, akti themelues apo statuti

³² Në bazë të nenit 2 të ligjit mbi përgjegjësinë penale të personave juridikë, dispozitat e këtij te fundit janë të ligjshme dhe aplikohen vetëm nëse janë në përputhje dhe si rrjedhim interpretohen në mënyre koherente me dispozitat e kodit penal

³³ Në lidhje me këto problematika këshillojmë leximin e monografise E. BOZHEKU – I. ELEZI, *Përgjegjësia penale e personave juridikë – Manual teorik praktik*, cit., f. 111. E. BOZHEKU – I. ELEZI, *Përgjegjësia penale e personave juridikë*, edicion i dytë i rishikuar dhe azhurnuar

³⁴ Për më shumë shih monografinë e sapo cituar

Në bazë të nenit 2 të ligjit 9754 datë 24.06.2007 dispozitat e tij mund të aplikohen vetëm nëse janë në përputhje me dispozitat e Kodit Penal.³⁵

Një dispozitë themeltare e këtij të fundit, që duhet zbatuar edhe kundrejt personave juridikë, është neni 14 K.P. në bazë të të cilit “...Askush nuk mund të dënohet për një veprim ose mosveprim të parashikuar nga ligji si veper penale, në qoftë se vepra nuk është kryer me faj. Quhet me faj personi që kryen veprën me dashje ose pakujdesi...”. Por në bazë të çfarë kriteresh duhet matur faji³⁶ i personit juridik?

Në bazë të dispozitave aktuale duket se përgjegjësia e personit juridik duhet bazuar vetëm në realizimin e veprës penale nga personat fizikë në emër ose në dobi të tij. Por, në këtë mënyrë personi juridik nuk ka asnjë lloj mundësie për tu mbrojtur. Nën këtë profil ligji 9754 datë 14.06.2007 është antikushtetues, sepse bie në konflikt me nenin 30 të Kushtetutës. Ky nen në mënyrë pozitive shpreh parimin e prezumimit të pafajësisë derisa nuk është provuar fajësia me vendim të formës së prerë. Nga neni mund të nxjerrim si rrjedhojë se: nga një anë është detyrë e organit të akuzës të provojë fajësinë penale, nga ana tjetër është e drejtë e të pandehurit të provojë pafajësinë e tij.

Por si mund të provojë pafajësinë e tij një person juridik kur ligji nuk i ofron asnjë mjet për të provuar se nuk ka faj? Me fjalë të tjera si mund të mbrohet e drejta për të treguar pafajësinë kur elementi subjektiv dashje/pakujdesi për personat juridik nuk është i disiplinuar nga ligji?

Është fare e qartë se duke qenë personat juridikë subjekte të ndryshëm nga personat fizikë, siç është theksuar më parë, nuk mund të aplikohet fajësia në konceptin subjektiv, të lidhjes psikologjike midis veprimit dhe faktit, por në atë normativ: fajësia e kuptuar si qortim për mos respektim të rregullave. Dhe pikërisht nën këtë profil, në ligjin tonë mungojnë rregullat që personi juridik duhet të ndjekë për të evituar fajësinë e tij edhe pse nga ana objektive është realizuar një veper penale në emër dhe në dobi nga personat fizik brenda tij.

Për këtë arsye është interesante zgjidhja që i është dhënë këtij problemi në një shtet me traditë të lashtë juridike sic është Italia.

Në vendin fqinj, aspekti i fajësisë së personit juridik është disiplinuar shprehimisht nga ligjvënësi në nenet 6 dhe 7 të ligjit 231/2001 dhe përbën sot një nga problematikat më të mëdha si nga ana e interpretimit doktrinar,³⁷ ashtu dhe në gjykimet e gjykatave italiane.

Për sa i përket subjekteve apikal (drejtues) ligji italian parashikon pafajësinë e personit juridik në rast se arrin të provojë se:

- organet drejtuese kanë aplikuar në mënyrë efikase, para realizimit të veprës penale, modele organizimi të afta për të parandaluar verifikimin e veprave penale si ajo që është realizuar;
- detyra e kontrollit dhe e azhurnimit të modelit t’i jetë dhënë një organi kontrolli autonom me të drejtë iniciative kontrolli;
- personat që kanë kryer veprën penale duke shmangur modelin në mënyrë të fshehtë dhe me shkelje të renda;
- të mos kenë patur omisione apo mungesa kontrolli nga ana e organizmit të vigjilances.

Më pas ligji italian neni 6 paragrafi 2 precizon se modelet organizative për parandalimin e veprave penale duhet të paktën t’i përgjigjen këtyre nevojave:

- të gjejnë dhe përcaktojnë aktivitetet shoqërore të cilat mund të jenë subjekt realizimi veprash penale;
- të parashikojnë protokolle specifike mbi programimin, formalizimin, mënyrën e marrjes së vendimeve në lidhje me parandalimin e veprave penale në zhvillimin e aktivitetit;
- të parashikojnë detyrime informative drejt organeve të vigjilances mbi funksionimin dhe respektimin e modelit;

³⁵ E. BOZHEKU – I. ELEZI, *Përgjegjësia penale e personave juridikë – Manual teorik praktik*, cit., f. 119.

³⁶ Del në pah në mënyrë tepër të qartë rëndësia e përcaktimit të elementit të fajësisë për të vendosur mbi përgjegjësinë penale të personit juridik.

³⁷ Në vendin fqinj interpretimet e doktrinë universitare konsiderohen themelore në zhvillimin e së drejtës. Tepër e lartë është pesha e këtij interpretimi në gjykatat e faktit dhe veçanërisht në gjykatën e lartë.

- të realizojnë një sistem disiplinor të aftë për të sanksionuar subjektet që nuk zbatojnë modelin;

Është precizuar se nuk mjafton vetëm adoptimi formal i këtyre masave, por është e nevojshme të provohet aftësia e tyre konkrete në parandalimin e veprave penale të kryer.³⁸

Pra nuk mjafton të provohet që modelet e organizimit janë aprovuar nga këshilli i administratorëve,³⁹ por duhet provuar nga ana e personit juridik që modelet kanë funksionuar⁽⁴⁰⁾, janë azhurnuar, që organi i kontrollit ka realizuar një aktivitet të vazhdueshëm e të detajuar. Vetëm në këtë mënyrë mund të provohet që modelet kanë qenë të afta për të parandaluar veprën penale e cila është realizuar, duke shmangur në mënyrë të fshehtë dhe me shkelje të rënda, nga organet drejtuese.

Për sa i përket përgjegjësisë së personave juridikë për vepra penale të realizuara nga subjektet që janë nën kontroll dhe mbikqyrje, neni 7 ligji 231/2001 parashikon përgjegjësinë e personit juridik:

- në rast se realizimi i veprës penale është bërë i mundur nga moszbatimi i detyrave drejtuese dhe vigjiluese (paragrafi 1);
- në rast moszbatimi të modelit organizativ edhe pse i aftë për të parandaluar realizimin e veprave penale (paragrafi 2);
- kur në model mungojnë parashikime mbi masat që duhen marrë për të garantuar aktivitetin në respekt të ligjit dhe që në bazë të natyrës, dimensioneve, të tipit të aktivitetit, duhet të jenë të afta për të zbuluar dhe eliminuar me shpejtësi situata të rrezikshme realizimi veprash penale (paragrafi 3);
- kur modeli nuk është modifikuar pas episodesh shkeljesh të tij, ose ka mungesë azhurnimi pas modifikimesh strukturnore, organizative, të aktivitetit (paragrafi 4).

Siç është theksuar nga doktrina italiane dhe si mund të kuptohet fare lehtë nga dispozitat e normave italiane, modelet organizative përbëjnë elementin kyç në bazë të të cilit duhet proceduar për vendosjen e fajësisë ose pafajësisë së personit juridik.

Pra, në mënyrë konkrete në praktikën e gjykatave italiane është pikërisht analizimi i këtyre modeleve dhe shqyrtimi i kapacitetit të tyre parandalues objekt i të gjithë procesit kundër personit juridik.

Modelet e organizimit dhe kontrollit efektiv (*compliance programs*). Mungesa e përcaktimi të kriterëve që duhet të ndjekë një person juridik, për të evituar përgjegjësinë penale për vepra penale të realizuara nga subjektet e parashikuara në nenet 3 dhe 4 ligji 8754, datë 14.06.2007, e bën legjislacionin shqiptar jo të efektshëm dhe aktualisht jo funksional në luftën kundër kriminalitetit të personave juridikë.⁴¹

Në bazë të nenit 2, ligji 9754, datë 14.06.2007 kundërshtimi i tij me parimet e Kodit Penal është i qartë. Në keto kushte, është e arsyeshme një nderhyrje sa më e shpejtë e ligjvënësit.⁴²

Megjithatë - e kemi theksuar disa herë – pikërisht në bazë të nenit 2, është detyrë e subjekteve të thirrur në aplikimin dhe interpretimin e ligjit, si në praktikë (avokatë, gjyqtarë, prokurorë), ashtu edhe në teori (profesorë, docentë dhe studiues të së drejtës penale) të japin një shpjegim dhe një interpretim sa më funksional të tij.⁴³

Si rrjedhim, konsiderojmë të domosdoshme zhvillimin e një tentative interpretuese të ligjit në fjalë edhe nën profilin e gjetjes dhe interpretimit të elementeve të aftë për të evituar përgjegjësinë

³⁸ Gjykata e shkallës së parë Milano, seksioni X , 20.IV.2007. I pandehuri My Chef.

³⁹ Gjykata e shkallës së parë Napoli, 26.VI.2007. i pandehur Impregilo s.p.a.

⁴⁰ Gjykata e shkallës së parë Milano, Seksioni IV, 11.XII.2006.

⁴¹ E. BOZHEKU, *Alcune riflessioni sul codice penale albanese*, në *Diritto&Diritti, Rivista giuridica elettronica pubblicata su Internet*, URL : <http://ëëë.diritto.it>, ISSN : 1127-8579, korrik, 2010, ëëë.diritto.it/docs/30027.

⁴² E. BOZHEKU, *Përgjegjësia penale e personave juridikë. Probleme interpretuese dhe aspekte krahasuese me legjislacionin italian*, cit. f. 205.

⁴³ Mbi kete aspekt shih E. BOZHEKU, *Alcune riflessioni sulla responsabilità penale delle persone giuridiche in Albania*, në *Diritto Penale Contemporaneo*, tetor 2012, <http://ëëë.penalecontemporaneo.it/upload/1346935432>.

penale të personave juridikë, duke respektuar kështu parimin e fajësisë (dhe të pafajësisë) të afirmuar si në neni 30 të Kushtetutës, ashtu edhe në nenin 14 të Kodit Penal.

Duhet thenë se ligji ynë është tepër konfuz.

Megjithatë le të mundohemi të gjejmë një linjë interpretuese koherente me parimet e Kodit Penal, të aftë për të garantuar funksionalitetin e ligjit 9754, datë 14.06.2007.

Kodi Penal në nenin 14 pika 1 parashikon se askush nuk mund të dënohet për një veprim apo mosveprim që përbën veprë penale nese e nuk e realizon atë faj. Më pas, në pikën 2 të nenetit 14 k.p. përcaktohen kriteret e fajit: pra dashja dhe pakujdesia.

Në bazë të ninit 2 të ligjit 9754, datë 14.06.2007 ky i fundit duhet të interpretohet në harmoni me nenet e Kodit Penal.

Kjo do të thotë se i takon interpretuesit që të gjej interpretimit më koherent të disiplinës së personave juridikë në përputhej ne Kodin dhe kjo vlen edhe në lidhje me institutin e fajësisë.

Duke u nisur nga këto premisa është e arsyeshme që fajsinë e personit juridik ta kuptojmë si fajsi me faj, e cila qendron në një qortim që mund dhe duhet ti behet atij për mënyrën e organizimit të tij e cila ka lënë mundësinë e realizimit të një veprë penale nga subjektet e nenetit 3 në emër dhe në dobi të tij.

Pra, faj i personit juridik qëndron tek mos organizimi i aftë për të evituar vepra penale. Me fjalë të tjera: po të kishte qënë i organizuar mirë personi juridik, me anë të organeve kontrolluese brënda tij, do të kishte evituar veprën penale.

Pra mungesa e organizimit është faj që mund ti shqiptohet personit juridik, në koherencë me nenin 14 pika 1 k.p. Pika 2 e tij nuk mund të gjej aplikim pasi i përket sferës psikologjike e cila është e aplikueshme dhe koherente vetëm me profilin e përgjegjësisë penale të personave fizikë. Për personin juridik do të ishte jo llogjike të flitet për dashje apo pakujdesi ndërsa është koherente të mund të flitet për një mos organizim të aftë për të evituar veprën penale; mos organizimi që vë në faj personin juridik, më përputhet me nenin 14 pika 1 të Kodit Penal.

Por cilët janë kriteret që duhet të merren parasysh nga gjykatat për të vlerësuar nëse organizimi i personit juridik ka qënë apo jo i aftë për të evituar veprën penale të realizuar në interes dhe dobi të tij???

Ligji 9754, datë 14.06.2007, nuk cakton kriteret për disiplinimin e fajësisë (pafajësisë) së personit juridik. Pra nuk jep kriteret të qarta mbi cilat janë kushtet që personi juridik mund të quhet përgjegjës edhe nën planin subjektiv për realizimin e veprave penale nga subjektet brnda tij në interes (emër) apo avantazh (dobi) të tij.

Megjithatë, te disa dispozita flitet për modele organizimi dhe kontrolli efektive (shih nenet 14 dhe 20), edhe pse nuk përcakton se çfarë janë dhe si funksionojnë këto modele.⁴⁴

Konkretisht, neni 14 pika 4, ligji 9754, datë 14.06.2007 thekson se *“brenda kompetencave të përcaktuara nga gjykata, administratori [kur personit juridik i është shqiptuar masa e administrimit të kontrolluar] kujdeset edhe për zbatimin dhe përmbushjen me sukses të modeleve të organizimit dhe kontrollit efektiv për parandalimin e veprës penale”*.

Neni 20 parashikon si rrethanë lehtësuese të përgjegjësisë penale të personit juridik rastin kur ky i fundit *“ka eliminuar mangësitë organizative, që kanë sjellë si pasojë veprën penale, nëpërmjet zbatimit të modeleve organizative, të përshtatshme për parandalimin e veprës penale”*.

Megjithatë, pikërisht citimi i modeleve në këto nene na bën të mendojmë se ligjvënësi ynë, në hartimin e ligjit, e njëj institutin e modelit të organizimit dhe të kontrollit por (në menyrë paradoksale, do të thoshim gati qesharake) ka harruar disiplinimin e tij. Kjo na bën të ndihemi më të sigurtë se, me anë të një propozimi të përshtatshëm mbi përmbajtjen dhe aplikimin e modeleve organizative dhe kontrollues, të mund t'i japim ligji 9754, datë 14.06.2007 një fizionomi komplete, duke plotësuar gabimin e ligjvënësit.

Natyrisht, qëndron fakti se kjo duhet të ishte bërë nga ligjvënësi, i cili nuk ka përcaktuar çfarë janë modelet organizative, si funksionojnë, kriteret që duhet të përmbajnë për të qënë të

⁴⁴ E. BOZHEKU – I. ELEZI, *Përgjegjësia penale e personave juridikë – Manual teorik praktik*, cit., f. 122

përshtatshëm për parandalimin e veprave penale; cilët janë subjektet e kontrollit dhe kriteret që duhet të përmbushin për të zhvilluar këtë funksion; detyrat dhe kompetecat e tyre në lidhje me kontrollin e modeleve.⁴⁵

Gjithësesi, nga interpretimi i bashkangjitur i neneve 14 dhe 20 mund të nxjerrim si përfundim se, nga momenti që modelet citohen në lidhje me rastet kur personi juridik ka kryer veprën penale.

Nga kjo nxjerrim se modelet mund dhe duhet të aplikohen nga personat juridik edhe (dhe veçanërisht) në mënyrë paraprake pasi vetëm kështu mund të evitohen përgjegjësinë penale për veprat penale të realizuara në emër ose në dobi të tyre nga personat fizik të parashikuar nga nenet 3 dhe 4.

Një konfirmim të këtij interpretimi e gjejmë tek neni 20 i ligjit në fjalë. Nëse realizimi dhe aplikimi konkret dhe efikas i modeleve të organizimit pas kryerjes të veprës penale (sipas nenit 20) mund të merret parasysh vetëm si rrethanë lehtësuese, aq më tepër hartimi dhe aplikimi i tyre paraprak (pra para kryerjes së veprës penale) nga ana e personit juridik duhet të merret parasysh në vlerësimin e përgjegjësisë (ose jo) penale të tij.

Pra, edhe pse ligji nuk thotë shumë mbi modelet, jemi të mendimit të hartimi dhe aplikimi i tyre nga ana e personave juridikë, edhe nën formën e kodeve etike, për të evituar realizimin e veprave penale në emër dhe në dobi të tyre duhet të vlerësohet nga ana e gjykatave në planin e përjashtimit të përgjegjësisë penale të personave juridikë.

Për mendimin tonë, edhe pse ligjvënësi ka harruar ta shprehë, personat juridikë nëse duan të evitohen përgjegjësinë e tyre penale janë të detyruar të realizojnë këto modele në mënyrë paraprake (pra përpara realizimit të veprave penale). Kjo nxirret fare lehtë edhe nga interpretimi i nenit 14 të ligjit 9754, datë 14.06.2007 në pjesën ku përcakton se është detyrë e administruesit (në rastet kur personit juridik i aplikohet masa e administrimit të kontrolluar) që të “*kujdeset edhe për zbatimin dhe përmbushjen me sukses të modeleve të organizimit dhe kontrollit efektiv për parandalimin e veprës penale*”. Pra, administruesi duhet që, gjatë menaxhimit të personit juridik në kuadrin e zbatimit të dënimit të masës së administrimit të kontrolluar, të krijojë premisat që personi juridik i kontrolluar, pas pushimit të kësaj periudhe, të zhvillojë aktivitetin e tij konform rregullave ligjore, të cilat shohin në modelin e organizimit dhe kontrollit efektiv mjetin për realizimin e një etike ligjore. Por, në qoftë se personi juridik pas periudhës së administrimit të kontrolluar duhet të ketë një model, kjo do të thotë se ky i fundit është akoma e më i domosdoshëm në rastet kur personi juridik nuk ka realizuar ende një vepër penale.

Interpretimi që sollëm duket i arsyeshëm, pasi shfaq jo vetëm *ratio juris* por edhe *ratio legis* që udhëheq (apo duhet të udhëheqë) të gjithë sistemin e përgjegjësisë penale të personave juridikë.⁴⁶

Natyrisht nga momenti që ligjvënësi nuk e përcakton si të detyrueshëm adaptimin e një modeli organizues, personat juridikë janë të lirë që të mos e realizojnë dhe të mos e aplikojnë. Por në qoftë se do të thërriten si përgjegjës penal përpara një gjykate në lidhje me një vepër penale të realizuar në emër dhe në dobi nga vartësi apo subjektet apikal të saj do ta kenë tepër të veshtirë – madje do të thoshim të pamundur – të mund të provojnë pafajësinë e tyre, pasi, në këtë rast, prova se kanë bërë të pamundurën për të evituar veprën penale, do të jetë një *probatio diabolica* e konkretisht e perealizueshme.⁴⁷

Prandaj, ftojme që të kihet tepër vëmendje në këtë kuadër, veçanërisht nga personat juridikë të cilëve u aplikohet ligji; është e mjaftueshme të kujtojmë parimin e *Ipoktatit: primum non nocere* (“*me mirë të parandalosh se sa të kurosh*”).

Çdo koment i mëtejshëm është i papërshtatshëm: *intelligenti pauca*.

⁴⁵ E. BOZHEKU – I. ELEZI, *Përgjegjësia penale e personave juridikë – Manual teorik praktik*, cit., f. 123

⁴⁶ Për një argumentim më të thellë lidhur shih E. BOZHEKU – I. ELEZI, *Përgjegjësia penale e personave juridikë*, Tiranë, 2017 edicion i II i rishikuar dhe azhornuar

⁴⁷ *Ibidem*

Në faqet në vijim do të arsyetohet në mënyrë të përgjithshme mbi përmbajtjen që duhet të ketë një model organizimi dhe kontrolli efektiv për të evituar përgjegjësinë penale të personave juridikë; përmbajtje që – e ritheksojmë – do të kishte qënë më mirë që të ishte përcaktuar nga ligjvënësi.⁴⁸

Kriteret bazë që duhet të ketë një “compliance program” për të evituar përgjegjësinë penale të personit juridik. Një model organizimi dhe kontrolli efikas, në radhë të parë duhet të përshkruajë në mënyrë të detajuar sjellejt që duhet të mbahen si nga subjektet apikal, ashtu edhe nga vartësit dhe nga subjektet e tjerë që zhvillojnë një aktivitet për personin juridik. Këto sjellje duhet të përcakton si në kadrin e marrëdhënieve brenda personit juridik, ashtu edhe me subjekte të tretë me të cilët zhvillojnë aktivitetin e tyre në emër të personit juridik. Pra është e nevojshme që personi juridik të aplikojë një kod etik sjelljesh të punonjësve të tij.

Modeli duhet të përmbajë një listë të detajuar të sektorëve në të cilët mund të realizohen vepra penale. Pra, duke bërë një vetë-vlerësim, personi juridik duhet të gjejë sektorët ku mund të kryhen vepra penale nga drejtuesit apo vartësit e tij. Së dyti, duhet të monitorohen dhe analizohen sektorët më të ekspozuar drejt paligjshmërisë si brenda strukturës organizuese, ashtu edhe subjektet e jashtëm (e kemi fjalën për subjektet e parashikuar në nenin 3 pika c) ligji 9754, datë 14.06.2007).

Gjithashtu, modeli duhet të influencojë edhe fazën manaxheriale të personit juridik, në kuptimin se modeli duhet të japë linjat e përgjithshme lidhur me marrjen e vendimeve. Me fjalë të tjera, modelet duhet të parashikojnë protokolle specifike mbi programimin, formalizimin, mënyrën e marrjes së vendimeve si në lidhje me parandalimin e veprave penale, ashtu edhe në zhvillimin e aktivitetit. Për shembull marrja e çdo vendimi të jetë e shkruar në mënyrë që të kontrollohet më lehtë shkalla e ligjshmërisë (natyrisht në përputhje me dinamikat vendimmarrëse të personit juridik në zhvillimin e aktivitetit të tij); në realizimin e aktiviteteve të caktuara (për shembull për pjesmarrjen në një tender); vendimet të merren në formë kolegjiale ose të informohen menjëherë organet kontrollues.

Personi juridik duhet të zgjedhë me kujdes drejtuesit e tij në mënyrë që të evitojë administrimin nga subjekte që nuk kanë precedent penal.

Modeli i adaptuar nga personi juridik duhet të parashikojë ndarjen e burimeve financiare për realizimin dhe zhvillimin e aktiviteteve të caktuara si dhe kotabilizimin e shpenzimeve.⁴⁹

Modeli duhet të parashikojë trajnime të posaçme të punonjësve mbi përmbajtjen e tij, si dhe mbi sjelljen që duhet të ketë sejcili prej tyre në zhvillimin e aktiviteteve në emër ose në përfaqësim të personit juridik, apo çdolloj tjetër aktiviteti që i sjell një dobi imediate personit juridik.⁵⁰

Gjithashtu, duhet që modeli të përmbajë një sistem informues të shpejtë dhe të përshtatshëm, pasi vetëm në këtë mënyrë mund të realizohet një kontroll efikas. Më konkretisht, modeli duhet të parashikojë një sistem monitorimi dhe informimi më anë të të cilit nëpunësit mund të njoftojnë personin juridik (konkretisht organet e kontrollit të modelit) rreth kryerjes së veprave penale, pa i ekspozuar.

Një ose më shumë anëtarë të këshillit drejtues, ose funksionarë me pozita të larta administruese, të kenë si detyrë verifikimin e respektimit të modeleve nga nëpunësit. Megjithatë, do të ishte e arsyeshme që detyra e kontrollit dhe e azhurnimit të modelit t’i jepet një organi kontrolli autonom me të drejtë iniciative kontrolli dhe me të drejtë marrje sanksionesh disiplinore.⁵¹

Modeli duhet të përcaktojë gjithashtu se, kur një vepër penale është realizuar, personi juridik duhet të marrë masa për të evituar përsëritjen e saj.⁵²

Modeli duhet të jetë efikas.

⁴⁸ E. BOZHEKU – I. ELEZI, *Përgjegjësia penale e personave juridike – Manual teorik praktik*, cit., f. 124

⁴⁹ E. BOZHEKU – I. ELEZI, *Përgjegjësia penale e personave juridikë*, Tiranë, 2017 edicion i II i rishikuar dhe azhurnuar

⁵⁰ E. BOZHEKU, *Kriteret për përgjegjësimin penal të personave juridikë nën profilin subjektiv*, në *Avokatia*, n. 1, 2012, f. 42

⁵¹ *Ibidem*

⁵² G. BENSON, *Code of Ethics*, në *Journal of Business Ethics*, 1989, n. 8

Efikasiteti mund të arrihet vetëm nëse parashikohet një sistem denoncimi të çdo shkeljeje të tij dhe një sistem disiplinor të përshtatshëm, të aftë për t'u dhënë shkelësve sanksionet e duhura. Në rast shkeljeje, nuk mjafton vetëm adoptimi formal i masave ndëshkuese kundrejt personave fizikë të cilët kanë realizuar veprën penale (objektivisht në emër dhe në dobi të personit juridik), por është e nevojshme të provohet aftësia konkrete e masave të parashikuara në model dhe të aplikuara në rastin konkret, për të parandaluar realizimin në të ardhmen e të njëjtës vepër penale.⁵³

Modeli duhet të përditësohet herë pas here duke mbajtur parasysh ndryshimet e dinamikave, të teknologjisë dhe kohës në zhvillimin e aktivitetit.

Për mendimin tonë, modeli duhet edhe të prezantohet përpara një subjekti publik (si mund të jetë Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë ose Ministria e Financave dhe Ekonomisë) për të marrë një vlerësim zyrtar mbi efikasitetin e tij. Ky vlerësim, që nuk mund të ketë si efekt përjashtimin direkt (*sic et simpliciter*) të përgjegjësisë së personit juridik, mund të rezultojë i rëndësishëm në krijimin e një etike ligjore të personave juridikë, të cilët me anë të prezantimit të modelit pranë subjektit shtetëror tregojnë se aderojnë apo duan të aderojnë në një etikë ligjshmërie.

Me fjalë të tjera, edhe pse aprovimi i efikasitetit të modelit nga një institut shtetëror nuk mund të quhet i aftë për të përjashtuar përgjegjësinë penale të personit juridik – pasi ky vlerësim i përket vetëm gjykatës së thërritur për të përcaktuar përgjegjësinë penale të tij pas realizimit të një veprë penale nga njëri nga subjektet e personit juridik në emër ose në dobi të tij – aprovimi mund të merret parasysh në kuadrin e uljes së dënimit nga ana e gjykatës.

Në qoftë se personi juridik arrin të provojë se ka aplikuar në mënyrë korrekte parametrat e mësipërm, nuk mund të vishet me përgjegjësi penale.

Jemi të mendimit se, përtej dhënies së provës se adoptimit të një modeli adekuat, personi juridik duhet edhe të provojë se personat fizikë që kanë kryer veprën penale kanë shmangur modelin në mënyrë të fshehtë dhe me shkelje të rënda. Përveç kësaj prove, personi juridik duhet edhe të provojë se nuk ka patur omisione apo mungesa kontrolli nga ana e organizimit të kontrollit.⁵⁴

Medojmë se i takon palës akuzuese të provojë se modeli i adaptuar nga personi juridik nuk është efikas në parandalimin e veprave penale, si ajo e realizuar nga personi fizik, vepër për të cilën personi juridik është thirrur gjithashtu si përgjegjës nën profilin penal.

Lidhur me veprat penale të realizuara nga vartësit dhe subjektet e tjerë (të cilët kanë lidhje me personin juridik falë një prokure përfaqësimi) neni 3 i ligjit 9754, datë 14.06.2007 përcakton se përgjegjësia penale e personit juridik lind vetëm nëse këto subjekte kanë vepruar “*në emër ose në dobi të tij, për shkak të mungesës së kontrollit apo të mbikëqyrjes nga personi që drejton, përfaqëson dhe administron personin juridik*”.

Pra, për këto kategori subjektësh nuk mjafton vetëm realizimi i veprës penale në emër dhe në dobi të personit juridik, por duhet edhe që vepra të jetë realizuar për “*shkak të mungesës së kontrollit apo të mbikëqyrjes nga personi që drejton, përfaqëson dhe administron personin juridik*”.

Për mendimin tonë, në këto raste, përgjegjësia penale e personit juridik lind nëse realizimi i veprës penale është bërë i mundur nga moszbatimi i detyrave drejtuese dhe kontrolluese. Kjo mund të ndodhë në rast moszbatimi të modelit organizativ, edhe pse konkretisht i aftë për të parandaluar realizimin e veprave penale.⁵⁵

Natyrisht i takon akuzës të provojë se kontrolli nga organet përkatëse ka qënë i pa aftë për të evituar realizimin e veprës penale.

Organi i kontrollit të modelit organizues dhe kontrollues. Që një model organizues dhe kontrollues të jetë me të vërtetë efikas dhe, si rrjedhim, i aftë për të përjashtuar përgjegjësinë penale të personave juridikë, është e nevojshme që t'i nënshtrohet një kontrolli të vazhdueshëm nga një

⁵³ E. BOZHEKU – I. ELEZI, *Përgjegjësia penale e personave juridike – Manual teorik praktik*, cit., f. 126

⁵⁴ J. WEBER, *Institucionalizing Ethics into Business Organisations a Model and Research Agenda*, në *Business Ethics Quarterly*, 1993, f. 419 dhe vazhdim

⁵⁵ E. BOZHEKU – I. ELEZI, *Përgjegjësia penale e personave juridikë*, Tiranë, 2017 edicion i II i rishikuar dhe azhurnuar

subjekt i pavarur nga personi juridik. Pra, është e nevojshme që brenda një personi juridik të krijohen struktura autonome me qëllim kontrollin e zbatimit të rregullave të përshkruara në modelin organizues.⁵⁶

Natyrisht që për të qënë me të vërtetë efektiv, organi i kontrollit duhet të jetë i pavarur nga personi juridik, në kuptin që nuk duhet të jetë i varur nga organet drejtuese (si administratorët).

Struktura duhet të ketë një buxhet të posaçëm dhe të ketë mundësi për të kontrolluar në çdo moment çdo aktivitet të personit juridik pa patur nevojë për asnjë lloj leje. Jemi të mendimit se ky organ duhet të zgjidhet direkt nga asambleja e përgjithshme. Jemi të ndërgjegjshëm se, në lidhje me shoqëritë aksionare, mund të lindin probleme në kuadrin e zgjedhjes së pjestarëve të këtij organi pasi numri i aksionerëve mund të jetë tepër i madh. Megjithatë, në këto raste, në statutin e shoqërisë mund të percaktohet që zgjedhja e organit kontrollues të modelit, të bëhet nga këshilli i administrimit në rast sistemi me një nivel,⁵⁷ ose nga këshilli mbikqyrës,⁵⁸ në rast sistemi me dy nivele.

Anëtarët e organit kontrollues të modelit organizues duhet të jenë individë që gëzojnë prestigj dhe nder në shoqëri, si edhe me aftësi të larta profesionale në fushën e parandalimit të veprave penale.⁵⁹ Gjithashtu, të njohin realitetin e personit juridik, të kenë aftësi teknike në formimin e personelit, në aplikimin e metodologjive të nevojshme për zbulimin e veprave penale brenda shoqërisë; të kenë njohuri në fushën e psikologjisë dhe të administrimit të burimeve njerëzore, të kenë njohuri juridike dhe ekonomike etj.⁶⁰

Subjektet të cilët formojnë organin kontrollues të modelit organizues nuk duhet të kenë interesa apo lidhje personale apo farefisnore me drejtuesit e personit juridik.⁶¹ Organi mund të përbëhet nga subjekte të cilët nuk kanë lidhje me personin juridik (si psikolog, avokat, ekspert kontabël, ekonomist, njerëz me eksperiencë në fushën menaxheriale etj) dhe subjekte të brendshëm të tij. Per mendimin tonë, mund të marrin pjesë si antarë të tij vetëm ato subjekte të cilët nuk luajnë një rol drejtues në shoqëri, por që kanë një rol kontrollues si, për shembull, anëtarët e këshillit të administrimit apo të këshillit mbikqyrës.⁶²

⁵⁶ Mbi kriteret që duhet të ndiqen në formulim e një modeli organizues dhe kontrollues të aftë për të evituar realizimin e veprave penale shih R. RODORF, *I criteri di attribuzione della responsabilità. I modelli organizzativi e gestionali idonei a prevenire i reati*, në *Le Società*, n. 11, 2001, f. 1303 dhe vazhdim; P. SFAMENI, *La responsabilità delle persone giuridiche: fattispecie di disciplina di modelli di organizzazione, gestione e controllo*, në A. ALESSANDRI *Il nuovo diritto penale delle società*, Milano, 2002, f. 96 dhe vazhdim

⁵⁷ Këshilli i administrimit është organi i cili kontrollon aktivitetin e administratorëve të shoqërisë tregtare. Zbaton politikat e caktuara nga statuti dhe asambleja e aksionerëve etj. Në bazë të nenit 154 paragrafi 1 pikat a), b) f) ligji 9901, datë 14.04.2007 “*këshilli i administrimit ka këto të drejta dhe përgjegjësi: a) të japë direktiva për administratorët për zbatimin e politikave tregtare të shoqërisë; b) të kontrollojë e të mbikëqyrë zbatimin e politikave tregtare të shoqërisë nga administratorët; f) të emërojë dhe të shkarkojë administratorët, të ndajë kompetencat ndërmjet tyre*”. Në bazë të nenit 155 “*Këshilli i administrimit përbëhet nga të paktën tre apo një numër më i madh, por jo më shumë se 21 anëtarë. Anëtarët janë individë, shumica e të cilëve duhet të jenë të pavarur dhe të ndryshëm nga administratorët e shoqërisë. 2. Anëtarët e këshillit të administrimit zgjidhen nga asambleja e përgjithshme me shumicën e kërkuar në pikën 2 të nenit 145 të këtij ligji, duke zbatuar afatin e emërimit, të përcaktuar në statut.*”

⁵⁸ Në sistemin organizues me dy nivele, roli i kontrollorit të aktiviteteve të administratorëve kryhet nga këshilli mbikqyrës. Në bazë të nenit 166 të ligjit 9901, datë 14.04.2008 shprehimisht percaktohet së “*në sistemin e administrimit me dy nivele, administratorët drejtojnë shoqërinë dhe marrin vendime për mënyrën e vënies në zbatim të politikave tregtare, ndërsa këshilli mbikëqyrës, në cilësinë e organit mbikëqyrës, këqyr vënien në zbatim të këtyre politikave dhe përputhjen e tyre me ligjin dhe statutin.*”

⁵⁹ C. MANDUCHI, *The introduction of corporate "criminal" liability in Italy*, në *Diritto&Diritti, Rivista giuridica elettronica pubblicata su Internet*, URL : <http://ëëë.diritto.it>, ISSN : 1127-8579, dhjetor, 2010, <http://ëëë.diritto.it/docs/30795>

⁶⁰ E. BOZHEKU, *Kriteret për përgjegjësimin penal të personave juridikë nën profilin subjektiv*, në *Avokatia*, n. 1, 2012, f. 46

⁶¹ L. ANTONETTO, *Il regime del rapporto e della responsabilità dei membri dell'Organismo di Vigilanza*, në *Resp. Amm. Soc. Enti.*, n. 2008, f. 75 dhe vazhdim

⁶² Për një vlerësim mbi legjislacionin e ri tregtar në Republikën e Shqipërisë shih. A. MALLTEZI, *Tradita e qeverisjes së shoqërive aksionere në Shqipëri*, në ‘*Jus&Justicia*’, n.4, 2010, f. 147-148

Jemi të mendimit se, gjithsesi, organi kontrollues duhet të jetë pjesë e shoqërisë (edhe pse i pavarur nga organet drejtuese të saj). Kjo, për faktin, se po t'i jepet kjo detyrë një subjekti të jashtëm (si, për shembull, një shoqërie ekspertësh kontabël), personi juridik për të evituar përgjegjësinë e tij penale, mund t'ia hedh përgjegjësinë e pa-aftësisë së modelit organizues dhe kontrollues subjektivit të jashtëm. Në të kundërt, krijimi i një organi kontrolli brenda personit juridik bën që ky i fundit të jetë i kujdesshëm në krijimin e një subjekti më të vërtetë të pavarur dhe me të vërtetë të aftë për të kontrolluar modelin organizues dhe për të zbuluar subjektet të cilët nuk e respektojnë atë. Kjo, për faktin, se në qoftë që modeli nuk funksionon ose organi i kontrollit tregohet i paafte në realizimin e detyrës së tij, personi juridik do të përgjigjet penalisht në rast realizimi të një veprë penale nga subjektet e parashikuar nga nenet 3 dhe 4 të ligjit 9754, datë 14.06.2007.

Është pra detyrë e personit juridik të realizojë brenda tij organe të posaçme kontrolli të modelit organizues dhe kontrollues, për të evituar përgjegjësinë e tij penale ⁽⁶³⁾.

Për të evituar shpenzimet e një strukture të re, personi juridik mund t'i besojë rolin e organit kontrollues këshillit të administrimit (në sistemin me një nivel) apo këshillit mbikqyrës (në sistemin me dy nivele) duke garantuar – në kufijtë e kompetencave të organit kontrollues – edhe pjesëmarrjen e një numri të caktuar subjektësh, të cilët nuk janë të lidhur me të ⁽⁶⁴⁾.

Për mendimin tonë, në të gjitha rastet, roli i presidentit të organit kontrollues (OK) duhet t'i besohet një subjekti i cili nuk ka asnjë lidhje me shoqërinë (nuk mund të marrin këtë rol pra pjestarët e këshillit të administrimit apo të këshillit mbikqyrës). Kjo, mund të garantojë pavarësinë e drejtimit të organit kontrollues nga organet administrues të personit juridik. Mund të vendoset, bie fjala, në krye të tij një avokat, një ekspert kontabël, një ekonomist, një psikolog që nuk ka lidhje me personin juridik (p.sh. nuk është aksioner i tij, nuk ka funksione drejtuese apo nëpunësi brenda tij, nuk e përfaqëson me prokurë të posaçme apo të përgjithshme në zhvillimin e një apo disa aktiviteteve etj.).

Për sa i përket personave juridikë me një numer të vogël punonjësish, jemi të mendimit se funksioni i organit kontrollues mund t'i besohet edhe vetëm një subjekti (dhe jo një këshilli). Ky i fundit mund të jetë edhe organi drejtues i tij ⁽⁶⁵⁾. Në këtë rast – për mendimin tonë – është ky i fundit që duhet të konsultohet në mënyrë periodike me një subjekt të jashtëm (avokat, ekspert kontabël, ekonomist etj.). Ndërsa, për sa i përket organeve kontrollues (OK) në lidhje me grupimet e shoqërive tregtare ⁽⁶⁶⁾, jemi të mendimit se sejcila shoqëri e kontrolluar duhet të ketë një organ kontrollues të vetin. Megjithatë, mund të pranohet edhe mundësia e krijimit të vetëm një organi

⁶³ Jemi të mendimit se për të evituar një përgjegjësi penale për vepra penale të realizuara nga subjektet e parashikuar në nenet 3 dhe 4 të ligjit 9754, datë 14.06.2007, personat juridikë duhet të pajisen me një sistem kontrolli efikas të modeleve. Pra, nuk mjafton thjesht aprovimi i një modeli ku të përshkruhen rregullat etike që duhet të ndiqen nga punonjësit e tij, por është e nevojshme edhe realizimi i një organi të posaçëm brenda personit juridik i cili të kontrollojë efektivisht dhe në mënyrë të pavarur respektimin korrekt të rregullave të përcaktuara në model

⁶⁴ G. ZANALDA – M. BARCELLONA, *La responsabilità delle società e i modelli organizzativi*, Milano 2002, f. 72 dhe vazhdim

⁶⁵ F. BAVA, *La responsabilità amministrativa delle società e il sistema di controllo interno*, në “*Impresa c.i.*”, n. 1, 2003, f. 30 dhe vazhdim

⁶⁶ Grupimi i shoqërive tregtare disiplinohet nga nenet 207 dhe vazhdim, ligji 9901, datë 14.04.2008 “mbi tregtarët dhe shoqëritë tregtare”. Shprehimisht dispozita thotë se “vlerësohet se ekziston një marrëdhënie mëmë-shoqëri e kontrolluar, kur një shoqëri tregtare sillet e vepron rregullisht, sipas orientimeve dhe udhëzimeve të një shoqërie tjetër. Ky kontroll quhet grup kontrollues. 2. Kur një shoqëri, në bazë të pjesës së kapitalit të zotëruar në një shoqëri tjetër ose në bazë të një marrëveshjeje me atë shoqëri, ka të drejtë të emërojë të paktën 30 për qind të administratorëve, të anëtarëve këshillit të administrimit apo të këshillit mbikëqyrës të saj, apo kur ajo zotëron të paktën 30 për qind të totalit të votave në asamblenë e përgjithshme, atëherë kjo shoqëri vlerësohet si mëmë e shoqërisë tjetër, ndërsa shoqëria tjetër vlerësohet shoqëri e kontrolluar. Ky kontroll quhet grup influencues. 3. Të drejtat e mëmës mbi shoqërinë e kontrolluar, të parashikuara në pikën 2 të këtij neni, vlerësohen të tilla edhe në rastin kur këto të drejta ushtrohen nëpërmjet një shoqërie tjetër, të kontrolluar nga mëma apo nga një person i tretë, që vepron për llogari të kësaj shoqërie tjetër apo për llogari të vetë shoqërisë mëmë. 4. I treti prezumohet se vepron për llogari të shoqërisë mëmë, nëse ai përfshihet në përcaktimet e pikave 2 e 3 të këtij ligji.”

kontrollues të shoqërisë mëmë, i cili mund t'u delegojë një pjesë të funksioneve të tij disa subjekteve të caktuar brenda secilës shoqëri të kontrolluar ⁽⁶⁷⁾.

Hyrje mbi teknikat mbrojtëse të personave juridikë në planin gjyqësor dhe jashtë gjyqësor

Procesi penal, por më mirë të themi procesi në përgjithësi, është si një lojë “shahu”: për të fituar, thelbësore është “strategjia”. Një strategji e sukseshme mund të sjellë fitore edhe në rastet më të dëshpëruara; ashtu sikurse mungesa e strategjisë, apo ndjekja e një strategjie të gabuar, mund të rezultojë fatale për fatet e gjykimit dhe si rrjedhim të klientit.

Nuk është ky vendi dhe momenti për të shkruajtur në mënyrë të detajuar mbi strategjitë që mund dhe duhet të mbahen nga ana e avokatit në kuadrin e zhvillimit të një gjykimi penal.

Prandaj, në këtë shkrim do të përqëndrojmë vëmendjen në formë tepër sintetike vetëm në disa udhëzime mbi disa teknika mbrojtëse që avokatët mund të ndjekin në kuadrin e mbrojtjes së personave juridikë përpara dhe gjatë marrjes si përgjegjës për vepra penale në bazë të ligjit 9754, datë 14.06.2007.

Bëhet fjalë për disa tematika që kemi patur mundësinë t'i verifikojmë me sukses nga eksperiencia ligjore e zhvilluar për më shumë se dhjetë vite përpara gjykatave penale italiane dhe kryesisht përpara gjykatës penale të qytetit të Romë-s, në kuadrin e mbrojtjes së personave juridikë.

Megjithatë, shohim të nevojshme të paralajmërojmë lexuesin mbi faktin se çdo gjyq ka problematikën dhe veçoritë e tij specifike; prandaj strategjia më e mirë është ajo e të studiuarit konkretisht për rastin konkret, duke u fokusuar në thellimin e disiplinës në përgjithësi, ashtu edhe të problematikave specifike që sjell rasti konkret në veçanti.

Vademecum (udhërrëfyes) mbi mbrojtjen e personave juridikë në planin parandalues (jashtë gjyqësor). Tematika e përgjegjësisë penale të personave juridikë, ndryshe nga çdo tematikë tjetër, ka në thelb të saj parandalimin e realizimit të veprave penale nga personat juridikë.

Ajo lind dhe zhvillohet në të gjitha legjislacionet – edhe në tonin – në planin e fuqizimit të kulturës së ligjshmërisë brenda shoqërive tregëtare.

Prandaj, të gjitha legjislacionet, përfshirë edhe tonin, janë të ndërtuara në mënyrë të këtillë që personi juridik të mund të shmangë që në rrënjë realizimin e veprave penale në interes apo dobi të tij.

Kjo mund të arrihet vetëm me anë të realizimit të një sistemi organizimi të brendshëm të aftë për të evituar realizimin e veprave penale, në emër apo në dobi të tij, nga përfaqësuesit apo nga nëpunësit e personit juridik.

Mbi këtë dhe mbi bazën ligjore se ku mbështetemi mbi argumentin e realizimit të modeleve të organizimit dhe kontrollit për parandalimin e veprave penale nga personi juridik (konkretisht nenet 14 dhe 21 të ligjit 9754, datë 14.06.2007) shih PJESËN 1, KREU VII, paragrafi përkatës.

Nëse një person juridik realizon një sistem (model) organizimi dhe kontrolli të brendshëm të aftë për të evituar veprat penale, ka më shumë mundësi për tu mbrojtur: nëse ka adoptuar një model organizimi dhe kontrolli **ka mundësinë të provojë** përpara gjykatës se vepra penale e realizuar nga përfaqësuesit e tij vetëm formalisht mund të quhet në emër të tij, apo dobia mund të jetë vetëm një pasojë dytësore, por në asnjërin rast personi juridik nuk mund të quhet fajtor, pasi vepra penale e realizuar nga përfaqësuesi apo vartësi i tij, edhe pse në emër apo në dobi të tij, nuk paqyron politikën e tij të brendshme.

Me fjalë të tjera, nëse personi juridik harton dhe aplikon brënda tij, në mënyrë paraprake një model organizimi dhe kontrolli (*compliance programs*) të zhvillimit të veprimtarive nga ana e përfaqësuesve dhe/apo nëpunësve të tij në planin e evitimit të realizimit të veprave penale, edhe nëse merret nën gjykim për veprën penale të realizuar nga këta të fundit në emër apo në dobi të tij, mund të gjykohet i pafajshëm nëse tregon se këta subjektë kanë vepruar duke shmangur modelin.

⁶⁷ E. BOZHEKU – I. ELEZI, *Përgjegjësia penale e personave juridike – Manual teorik praktik*, cit., f. 131

Nëse personi juridik provon se ata (përfaqësuesit dhe/apo vartësit) nuk kanë respektuar parimet bazë ku mbështetet organizimi i personit juridik dhe objektivat e tij të shkruar në model, marrëdhënia e identifikimit organik midis përfaqësuesit dhe personit juridik bie, pasi përfaqësuesi ka dhunuar paktin me personin juridik; nuk ka respektuar parimet dhe rregullat e vënë nga personi juridik. Si rrjedhim, fakti i realizuar nga personi fizik nuk mund të thuhet se pasqyron politikën e personit juridik. Prandaj ky i fundit nuk mund të quhet përgjegjës.

Modeli dhe funksionimi korrekt i tij **tregojnë që personi juridik mban mbi respektimin e vlerave sociale;** sa më i detajuar, i realizuar mirë dhe efikas të jetë ai, aq më shumë mund të mbrohet teza se **personi juridik nuk donte** realizimin e veprës penale të kryer nga përfaqësuesi i tij, edhe pse kjo i ka sjellë një dobi apo kur është realizuar nga përfaqësuesi që ka vepruar në emër të tij.

Realizimi i modelit përbën një aktivitet që personat juridikë duhet të bëjnë në mënyrë paraprake, për t'i dalë përpara rrezikut të marrjes një ditë si të pandehur në bazë të ligjit 9754, dftatë 14.06.2007. Së bashku me modelin personat juridikë duhet të vënë në punë një **Organ Kontrolli** që të analizojë në formë periodike si funksionon dhe sa zbatohet ai nga përfaqësuesit apo nëpunësit. Nga eksperiencia jonë shumë-vjeçare në realizimin e modelit dhe në pjesëmarrjen në cilësinë e *Officer* në Organin e Kontrollit të modelit për disa kompani italiane të kolosit ndërkombëtar "Mc Donalds", kemi vënë re se për të qenë efikas, modeli duhet të bazohet në disa elemente specifike dhe konkretisht në ato që kemi parashtruar në PJESËN 1, KREU VII i këtij libri.

Gjithashtu, në lidhje me aktivitetin e kontrollit nga *Officers* të Organit të Kontrollit, kemi vënë re se sa më shumë kompetenca të kenë pjesëtarët e tij, në kuadrin e kontrollit të aktiviteteve të shoqërisë me qëllim parandalimin e realizimit të veprave penale nga punonjësit e saj (qofshin këta përfaqësues, vartës apo subjekte të tretë), aq më shumë ulet rreziku i realizimit të veprave penale nga ana e personit juridik dhe aq më shume rritet mundësia e provës së pafajësisë së personit juridik, nëse një vepër penale realizohet nga përfaqësuesit e tij në shkelje të modelit, duke i shpëtuar kontrollit të *Officers*. Më konkretisht, për këtë argument si dhe mbi kompetencat që duhet të këtë Organi i Kontrollit shih PJESËN 1, KREU VII, paragrafi përkatës.

Thirrja jonë është, nga një anë, ajo e sensibilizimit të kompanive tregtare dhe të personave juridikë në përgjithësi lidhur me rëndësinë e hartimit të modeleve të organizimit dhe kontrollit paraprak për shmangjen e veprave penale dhe ngritjes në gjirin e tyre të Organeve të Kontrollit të modeleve.

Nga ana tjetër, avokatëve, ekonomistëve, ekspertëve kontabël, menaxherëve, etj., u bëjmë thirrje të thellojnë tematikën e përpilimit të modeleve organizative dhe të diskutimit për zbatimin e tyre nga personat juridikë. **Hartimi i një modeli sot, mund t'i shpëtojë jetën personit juridik nesër...!!!**

Vademecum (udhërrëfyes) mbi mbrojtjen e personave juridikë në planin gjyqësor. Mbrojtja e personave juridikë në kuadrin e një gjykimi penal, edhe pse në plan të parë mund të duket e lehtë, pasi duket e ngjashme me mbrojtjen e personave fizikë, ka disa veçori specifike dhe kërkon një kujdes më të veçantë, si në planin e dispozitave procedurale, ashtu edhe në atë të formulimit të një strategjie efikase dhe të aftë për të çuar në pafajësinë e personit juridik.

Për të realizuar këtë, sugjerimi i parë që mund të bëjmë ka të bëjë me ndarjen e strategjisë së personit juridik nga ajo e personit fizik.

Më konkretisht, strategjia e personit juridik mund të përkohet deri diku me atë të personit fizik, por nga një moment e tutje është e nevojshme që ajo të ndahet dhe të vijojë në mënyrë paralele dhe autonome.

Dy strategjitë mund të përkojnë dhe të mbrohen lidhur me realizimin apo jo të veprës nga ana e personit fizik. Deri në këtë pikë është e qartë që interesi është i përbashkët. Nëse personi fizik do të shpallet i pafajshëm për veprën penale, pasi nuk e ka kryer atë, apo sepse nuk është provuar fajësia e tij, kjo rrethanë i vlen edhe personit juridik.

Megjithatë, mund të ndodhë që fajësia e personit fizik të jetë e paevitueshme. Në këto raste është detyrë e avokatit të personit juridik të bëjë të pamundurën që ajo mos të sjellë edhe përgjegjësinë e këtij të fundit.

Kjo është përpjekje dhe kjo është ajo për të cilën avokati i personit juridik duhet të punojë duke strukturuar një *'thema probandum'* sa më solide.

Nga ana procedurale sugjerojmë që personi juridik, në bazë të nenit 26 të ligjit 9754, datë 14.0.602007 mbi "përgjegjësinë penale të personave juridikë", të zgjedhë një përfaqësues që ka kompetencë në fushën ligjore apo në njohjen e akteve administrative brenda shoqërisë dhe mund të ndihmojë avokatin në kuadrin e strategjisë dhe administrimit të provave. Sipas neni 26, paragrafi 3 nuk mund të jetë përfaqësues i tij personi fizik që ka realizuar veprën penale nga e cila lind thirrja si i pandehur i personit juridik; ashtu sikur nuk mund të jetë përfaqësues një dëshmitar.

Për të provuar pafajësinë e tij, personi juridik duhet të orjentojë strategjinë mbrojtëse rreth dhënies së provës se vepra penale e realizuar nga përfaqësuesi:

- a. nuk i ka sjellë një dobi;
- b. është realizuar nga përfaqësuesi në interes personal, apo në interes të subjekteve të tretë;
- c. vetëm formalisht përfaqësuesi ka vepruar në emër dhe në llogari të personit juridik, por konkretisht ka vepruar jashtë tagrit të përfaqësimit të tij;
- d. vetëm formalisht përfaqësuesi ka vepruar në emër dhe në llogari të personit juridik, por konkretisht ka shkelur objektivat e parashikuara në aktin e themelimit dhe në statutin e personit juridik;
- e. vetëm formalisht përfaqësuesi ka vepruar në emër dhe në llogari të personit juridik, por konkretisht ai ka shmangur modelin organizues dhe të kontrollit, si dhe i është fshehur direktivave dhe kërkesave të përfaqësuesve të Organit të Kontrollit.

Në katër rastet e para (a,b,c,d) personi juridik nuk mund të quhet fajtor pasi mungon ana objektive e veprës penale të tij, pra ajo e realizimit të veprës nga përfaqësuesi apo vartësi "në emër" apo "në dobi" të tij.

Në rastet b), c), d) vetëm formalisht mund të thuhet se personi fizik ka realizuar veprën penale në emër të personit juridik, por konkretisht në asnjërin nga këto raste nuk mund të thuhet se vepronte në llogari dhe në "interes" të tij.

Nga ana argumentuese, lidhur më arsyet dhe shpjegimet që mund të jepen në këtë prizëm shiko PJESËN 1, KREU VI.

Në rastin e) i takon mbrojtësit të personit juridik të evidentojë me anë të provave se vepra penale e realizuar nga personi fizik nuk mund të sjellë edhe përgjegjësinë penale të personit juridik, pasi vepra penale nuk mund të quhet shprehi e politikës së personit juridik apo pasojë e një pakujdesie organizuese nga ana e tij në planin e parandalimit të veprës penale. Si rrjedhim, edhe nëse vepra penale është realizuar nga personi fizik (përfaqësues apo vartës) në emër, llogari, interes dhe dobi të personit juridik, avokati i këtij të fundit, nëse provon se personi fizik ka vepruar duke shmangur modelin dhe kontrollet e Organit të Kontrollit, atëherë personi juridik nuk mund të quhet me faj. Vepra penale e realizuar nga personi fizik nuk vjen si pasojë e mungesës apo e dobësisë së një politike manaxheriale të aftë për të evituar realizimin e një veprave penale, por nga një akt ekskluziv i personit fizik, i cili duke iu shmangur modelit, realizon veprën penale. Në këto raste, personi juridik nuk mund të përgjigjet për veprën penale, pasi mungon elementi i fajësisë (politika e tij manaxheriale është korrekte dhe koherente me vlerat sociale; ajo evidentohet nga zbatimi i një modeli efikas që shmanget me keqdashje nga personi fizik). Nga ana argumentuese, lidhur me arsyet dhe shpjegimet që mund të jepen në këtë prizëm, shiko PJESËN 1, KREU VII.

Gjithashtu, në planin e masës së dënimit.

Avokati i personit juridik duhet të sjellë argumenta dhe të përqëndrojë provën në lidhje me nivelin e përgjegjësisë dhe rrezikshmërisë, duke patur parasysh jo personin fizik dhe as veprën penale, por personin juridik.

Në këtë prizëm, mbrojtja e personit juridik duhet të evidentojë se ajo ka një strukturë të organizuar mirë dhe të aftë për të evituar realizimin e veprave penale në të ardhmen.

Ndërkohë, personi juridik duhet të hartojë dhe zbatojë një model organizues efikas në mënyrë që të ketë një ulje të dënimit në bazë të nenit 21 të ligjit 9754, datë 1406.2007.

Nga ana argumentuese, lidhur me arsyet dhe shpjegimet që mund të jepen në këtë prizëm, shiko PJESËN 1, KREU VIII.

Mbrojtja gjyqësore e një personi juridik dhe rëndësia e modeleve parandaluese në kuadrin e strategjisë procedurale: një kazus i zgjidhur për lexuesin. Lidhur me argumentin e modeleve organizuese të kontrollit parandalues të veprave penale e shikojmë të arsyeshme të sjellim një shembull nga eksperiencia jonë profesionale e mbrojtjes së personave juridikë në Republikën e Italisë, me anë të të cilit shpresojmë të qartësojmë edhe më tej rëndësinë që ka zbatimi paraprak i modeleve nga ana e personave juridikë, veçanërisht në kuadrin e mbrojtjes penale përpara gjykatave.

Kompania X ka si objekt ndërtimin e rrugëve; ka rreth 600 punonjës. Këta janë të organizuar në 5 sektorë, ku punojnë inxhinierë, ekonomistë, juristë, arkitektë, etj. Kompania ka realizuar një model organizues ku, ndër të tjera, parashikohen një sërë procedurash që administratori duhet të respektojë kur realizon kontakte me përfaqësues të institucioneve në kuadrin e realizimit të objektivave të kompanisë. Ajo ka ngritur edhe një Organ Kontrolli me 3 *officers* që verifikojnë zbatimin korrekt të modelit.

Konkretisht, ky i fundit, në lidhje me marrëdhëniet me administratën publike, parashikon se administratorët e shoqërisë nuk mund të marrin iniciativa për të të marrë pjesë në prokurime publike pa u konsultuar me oficeret e Organit të Kontrollit; nuk mund të marrin pjesë në bankete apo darka me funksionarë publikë pa i bërë një kërkesë paraprake dhe informuar Organin e Kontrollit; nuk mund të realizojnë mbledhje me funksionarë publikë pa informuar paraprakisht Organin e Kontrollit mbi argumentet që do të jenë objekt i takimit.

Megjithatë, administratori i Kompanisë, në shkelje të modelit, pa informuar Organin e Kontrollit, organizon një takim me një funksionar të lartë të ministrisë së infrastrukturave; i jep një shumë prej 50.000 euro për t'i garantuar fitimin e një tenderi nga kompania X për ndërtimin e një rruge. Pas disa javësh kompania X fiton tenderin.

Në këtë rast, është e qartë që administratori ka kryer veprën e korrupsionit aktiv.

Pyetja nuk është ka apo jo ai përgjigjësi për këtë vepër penale, por nëse ka apo jo përgjigjësi penale edhe personi juridik?

Në një shikim të parë, përgjigja duhet të jetë pohuese. Administratori vepron në emër, për llogari, në interes të shoqërisë dhe i sjell asaj një dobi.

Po a ka rrugë dalje për kompaninë X?

Nga ana strategjike si duhet të mbrohet ajo?

Cilat janë tematikat e provës që avokati i saj duhet t'i propozojë për shqyrtim gjykatës?

Si duhet të strukturojë provën, avokati i kompanisë?

Së pari, kompania duhet të provojë se ka hartuar dhe zbatuar një model organizimi dhe kontrolli për evitimin e veprave penale. Për këtë duhet të thirren si dëshmitarë ata që e kanë hartuar modelin dhe të shpjegojnë përpara Gjykatës pse ai mund të cilësohet si i aftë për të evituar realizimin e veprave penale.

Përgjigja natyrisht varet nga si është hartuar modeli; sa i detajuar ka qënë në planin e identifikimit të aktiviteteve që sjellin rrezik realizimi veprash penale nga ana e përfaqësuesve, vartësve apo subjeteve të tretë, si dhe masat që parashikohen në model për të evituar situata që mund të çojnë në realizimin e veprave penale në emër, llogari interes dhe dobi të personit juridik.

Përveç hartuesve të modelit, duhet të thirren si dëshmitarë drejtorët apo subjektet e tjerë, të cilët kanë një rol apikal (pra përfaqësojnë atë) brenda kompanisë, të ndryshëm nga përfaqësuesi që ka realizuar veprën penale dhe të shpjegojnë se cilat janë masat që kompania ka marrë që modeli të njihet dhe, veçanërisht të respektohet, si nga ata ashtu edhe nga vartësit.

Ata gjithashtu duhet të pyeten mbi si funksionon Organi i Kontrollit; çfarë komunikimesh i bëhen atij dhe çfarë kontrolli efektiv ushtron ai.

Një temë tjetër pyetjesh duhet të jetë ajo e sjelljes që subjekti që ka realizuar veprën penale (administratori) ka mbajtur; sa ky i ka respektuar më parë dispozitat e modelit; sa ia ka komunikuar aktivitetet e tij Organit të Kontrollit, etj.

Duhet të merren si dëshmitarë edhe disa punonjës të kompanisë, për të evidentuar si modeli i është komunikuar atyre; si janë formuar punonjësit për respektimin e tij; çfarë marrëdhëniesh dhe komunikimesh kanë patur me Organin e Kontrollit, etj.

Kjo është e rëndësishme për të provuar pafajësinë e personit juridik.

Të gjithë këto elementë janë të nevojshëm për të treguar se, jo vetëm modeli parashikonte rregulla specifike mbi sjelljet që duhet të mbante administratori, por edhe mbi sa efektiv ka qenë modeli në planin dinamik; më konkretisht sa i rreptë dhe efikas ka qenë aktiviteti i *Officers* të Organit të Kontrollit në verifikimin e zbatimit të kontrollit dhe evitimin që në rrejtje të situatave të paqarta, apo të shkeljeve të modelit nga përfaqësuesit apo vartësit. Si dëshmitar duhet të sillen nga avokati i kompanisë edhe *Officers* të Organit të Kontrollit, të cilët duhet të dëshmojnë mbi rolin e tyre; funksionin parandalues që ka modeli, si dhe aktiviteti i tyre në kuadrin e zbatimit të dispozitave të tij; sa informacione kanë kërkuar dhe kanë marrë mbi zbatimin e tij; sa kanë monitoruar sjelljet e dyshimta nga ana e punonjësve apo përfaqësuesve të kompanisë, etj.

Nëse nga provat del, nga një anë, se modeli ka qenë me të vërtetë i realizuar në mënyrë specifike dhe i aftë në përgjithësi për të evituar veprat penale dhe veçanërisht atë të realizuar nga administratori dhe, nga ana tjetër, se Organi i Kontrollit konkretisht ka funksionuar dhe e ka kryer detyrën e tij në formë korrekte duke bërë kontrollet e duhura, është e qartë se vepra penale e realizuar nga administratori nuk mund të sjellë edhe përgjegjësinë e kompanisë.

Nga provat e mbledhura në këtë formë del se administratori e ka shmangur modelin dhe ka evituar qëllimisht dhe me dredhi kontrollet e Organit të Kontrollit; si rrjedhim vepra penale e realizuar nga ai nuk mund të quhet si vepër penale e realizuar nga personi juridik.

Kjo për faktin se ky ka bërë gjithçka që ishte në mundësitë e tij për të evituar realizimin e veprës penale, si në planin abstrakt ashtu edhe në atë konkret. Fakti që ajo është realizuar në interes të tij dhe i ka sjellë një dobi, nuk tregon se ajo është një shprehje e politikës së kompanisë, as se vepra është realizuar nga një mungesë organizimi brenda saj për evitimin e veprave penale. Përkundrazi, nga provat del se organizimi i kompanisë ka qenë i aftë, në planin e rregullave të parashikuar në model, dhe efikas, në planin e mbikqyrjes së respektimit të modelit nga ana e Organit të Kontrollit. Për këto arsye, vepra penale nuk mund t'i atribuohet edhe personit juridik, pasi ai nuk ka faj në planin e neni 14 k.p., bazuar në faktin se sjellja e përgjithshme e kompanisë ka qenë korrekte dhe në respektim të plotë të vlerave sociale të afirmuara në Kodin Penal dhe, si rrjedhim, nuk do të kishte anjë arsye që personi juridik të qortohej.

Reflektime përfundimtare

Në përfundim të këtij punimi mbi një nga tematikat më të vështira dhe më problematike të së drejtës penale, jemi të mendimit se disiplina e përgjegjësisë penale të personave juridikë në Shqipëri, edhe pse tregon dëshirën e ligjvënësit për të arritur në standarte të larta juridike, nuk mund t'i shpëtojë një gjykimi kritik dhe skeptik. Ligji në fjalë paraqitet tepër konfuz, kontradiktor, me lakuna konceptimi të cilat nuk mund të mbushen vetëm nga studiuesit e së drejtës dhe të dogmatikës penale⁽⁶⁸⁾. Ligji objekt i këtij artikulli tregon mungesën e një arsytimi të thellë të ligjvënësit dhe të gjithë komunitetit juridik shqiptar rreth tematikës së përgjegjësisë penale të personave juridik. Duket se, si shpesh herë ndodh me ligjvënësin shqiptar, bëhet fjalë për një ligj, që nuk do të hezitonim ta quajmë, “parullë” për të treguar arritjet në sistemin juridik, por që në fakt jo vetëm nuk ka asgjë bashkëkohore dhe, në të kundërt, mund të bëhet me të vërtetë një mjet i rrezikshëm goditjeje i shoqërive tregtare të cilat nuk kanë, aktualisht, asnjë lloj mundësie mbojtjeje në sallat

⁶⁸ Ligji në fjalë nuk jep kritere për disiplinimin e fajësisë së personit juridik. Në mënyrë të pa kupeshme në disa norma flitet për modele organizimi dhe kontrolli efektive (shih nenet 14 dhe 20) pa përcaktuar se çfarë janë dhe si funksionojnë këto modele

gjqësore: kemi përshtypjen se, ashtu si rezulton i formular ligji 9754 datë 14.06.2007, shoqëritë tregëtare (personat juridikë) do të bëhen objekte ndëshkimi vetëm për faktin se disa vepra penale janë realizuar nga ana e punonjës, qofshin këto subjekte drejtues apo vartës, gjatë zhvillimit të aktivitetit të tyre në kuadrin (në emër) e personave juridikë apo që i kanë sjell një avantazh (dobi) atyre. Kemi frikë se tematika e fajsisë nuk do të merret fare parasysh edhe pse një nga shtyllat e së drejtës penale është ajo e elementit subjektiv.

Sygerimet interpretuese të dhëna nga ana jonë në këtë punim apo edhe në shkrime të tjera, bazohen tek një analizë e thellë dhe koherente e ligjit në fjalë në përputhjen me dispozitat e Kodit Penal, në respekt të parimit të jerarkisë së burimeve juridike, i afirmuar ky edhe nga neni 2 i ligjit 9754, datë 14.06.2007. Megjithatë, për kompleksitetin që kjo teknikë kërkon, dukë parë edhe stadin aktual të interpretimit të ligjit në fjalë nga ana e jurisprudencë, kemi përshtypjen se do kemi vendime jo koherente dhe siperfaqësore, pasi lënja e një interpretimi të gjera gjykatës i hap rrugën arbitraritetit.

Do të ishte e arsyeshme një ndërhyrje sa më e shpejtë e ligjvënësit për një rishikim të ligjit, duke modifikuar dhe integruar disiplinën aktuale, pas një arsytimi të thellë me të gjithë protagonistët e sistemit ekonomiko-ligjor, duke përfshirë këtu shoqëritë tregëtare, ambjentet, universitare, gjykatësit, prokurorët, avokatët dhe të gjithë ekspertët e së drejtës penale dhe së drejtës së shoqërive tregëtare.

Literatura:

Akte normative

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë (në fuqi)
- Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë (në fuqi)

Doktrinë

- G. ZANALDA – M. BARCELLONA, *La responsabilità delle società e i modelli organizzativi*, Milano 2002
 - F. BAVA, *La responsabilità amministrativa delle società e il sistema di controllo interno*, në “Impresa c.i”, n. 1, 2003
 - R. RODORF, *I criteri di attribuzione della responsabilità. I modelli organizzativi e gestionali idonei a prevenire i reati*, në ‘Le Società’, n. 11, 2001
 - A. ALESSANDRI *Il nuovo diritto penale delle società*, Milano, 2002
 - C. MANDUCHI, *The introduction of corporate "criminal" liability in Italy*, në *Diritto&Diritti, Rivista giuridica elettronica pubblicata su Internet*, URL : <http://www.diritto.it>, ISSN : 1127-8579, dhjetor, 2010, <http://www.diritto.it/docs/30795>
 - E. BOZHEKU, *Kriteret për përgjegjësimin penal të personave juridikë nën profilin subjektiv*, në ‘Avokatia’, n. 1, 2012
 - L. ANTONETTO, *Il regime del rapporto e della responsabilità dei membri dell’Organismo di Vigilanza*, në *Resp. Amm. Soc. Enti.*, n. 2008
 - A. MALLTEZI, *Tradita e qeverisjes së shoqërive aksionere në Shqipëri*, në ‘Jus&Justicia’, n.4, 2010
 - E. BOZHEKU, *Alcune riflessioni sul codice penale albanese*, në ‘Diritto&Diritti’, ‘Rivista giuridica elettronica pubblicata su Internet’, URL: <http://www.diritto.it>, ISSN: 1127-8579, korrik 2010, www.diritto.it/docs/30027
 - E. BOZHEKU – I. ELEZI, *Përgjegjësia penale e personave juridike – Manual teorik praktik*
 - E. BOZHEKU – I. ELEZI, *Përgjegjësia penale e personave juridikë*, Tiranë, 2017 edicion i II i rishikuar dhe azhornuar
 - I. ELEZI - S. KAÇUPI – M. HAXHIA, *Komentar i Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë*, Tiranë 2006
 - G. BENSON, *Code of Ethics*, në *Journal of Business Ethics*, 1989, n. 8
- Etj, etj.

Jurisprudencë

- Gjykata e shkallës së parë Milano, seksioni X , 20.IV.2007. I pandehuri My Chef.
- Gjykata e shkallës së parë Napoli, 26.VI.2007. i pandehur Impregilo s.p.a.
- Gjykata e shkallës së parë Milano, Seksioni IV, 11.XII.2006

